



PAGESA

► FAQE 11

Pensionet familjare, si do të llogariten me ligjin e ri, ndryshimet
Përcaktohen përfituesit dhe masa e pagesës për çdo kategori



VJEDHJA NE THESAR

BERISHA ALUDON PER DOSJE SEKRETE NE BANKEN E SHQIPERISE

► FAQE 4-5

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI IV - NR. 217 - E DIEL - 14-09-2014

Lexoni Dëgjoni Shikoni
EDICIONI MULTIMEDIAL
Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

21 JANARI RIHAPET DOSJA INA RAMA DO DESHMOJE NE PROKURORI

Hysni Burgaj e Agron Kuliçaj, dy ish-drejtuesit më të lartë të Policisë vihen para ligjit për refuzimin e urdhërit të Prokurorisë për arrestimin e gardistëve

► FAQE 2-3



Satirë politike



NGA **ARBEN DUKA**

I egër si një shpellar!

*Pyetja e vjetër,
na vjen vetvetiu,
përse kaq i egër,
është xha Saliu?!*

► Në faqen 25
bashkë me letra nga populli

Koment



NGA **AFRIM KRASNIQI**

Raporte elitare vs raporte militante mes shqiptarëve

► vijon në faqen 14

SUPLEMENTI "RILINDASI"



Luigj Gurakuqi po vritet për herë të katërt, reliket tij të braktisura

Historishkrimi, diskutimet për luftën si u zhduk termi "luftë civile"

► FAQE 15-22

ABUZIMI ME RRUGET

► FAQE 2-3

KLSH: Andi Toma ka shpërdoruar 13.7 mln euro

Njeriu i afërt i Familjes Berisha menaxhonte 400 mln euro në vit



STRUKTURA

PS nis grupin e punës në terren për zgjedhjet e 2015

► FAQE 9

Blog/ Grimca Urbane



NGA **EVIS CERGA**

A ishim më mirë kur ishim më keq?

► vijon në faqen 14



Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara
sipas protokolleve të
njekësive bashkëkohore
nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 868
Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

DOSJA Andi Toma shpëtoi nga burgu bashkë me ish-ministrin e Transportit Lulzim Basha “për procedurë” vite më parë. Ishin akuzuar për abuzime me fondet e Rrugës së Kombit



Andi Toma

ABUZIMI Dosja po hetohet nga njësisia Task Forcë e Prokurorisë së Tiranës. Toma, pas paraqitjes së projekteve u ka kryer parapagim firmave, kur ende s’kishin nisur investimet



AKUZA

KLSH: Andi Toma, shpërdorim 13.7 milionë euro te Rrugët

Edhe dy ish-krerë të Autoritetit Rrugor në Prokurori

GENC KONDI
TIRANË

Ish-drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar Andi Toma dhe një nga zëvendësat e tij kanë shpërdoruar afro 2 miliardë lekë të reja apo 13.7 milionë euro. Kjo shifër ka dalë nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi prokurimet me fonde publike për vitin 2013, ku janë zbuluar shkelje të natyrave të ndryshme.

Këto shkelje kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave për objektet “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (seg. Kthesa e Saukut-Bregu i lumit)” loti 1, loti 2, loti 3 dhe “Ndërtim rrugës Lushnje-Berat” loti 2, ku, sipas KLSH, është vendosur kushti për “paradhënie”, pas publikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si dhe para marrjes

së miratimit nga Ministri i Financave. Për pasojë është urdhëruar kryerja e pagesave për paradhënie për kontratat e sipërcituar gjithsej në vlerën 258,4 milionë lekë, duke vepruar në mënyrë fiktive në shpërdorim të detyrës

me pasojë shkelje të interesave të shtetit dhe efekte negative për buxhetin, në një kohë që kjo shumë mund të ishte me efektivitet nëse do përdorej për likuidimin e Operatorëve të tjerë Ekonomikë që kanë përfunduar punimet në mënyrë

uljen e borxhit ndaj tyre.

Gjithashtu rezultoi se janë urdhëruar dhe paguar më tepër 3,3 milionë lekë nga vlera e miratuar për paradhënie nga Ministria e Financave.

Për këtë KLSH ka rekomanduar fillimin e procedimit

penal për konsumin e veprës penale shpërdorim detyre në ngarkim të Andi Tomës, ish-Drejtor i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili në përmbushje të detyrave të tij funksionale ka kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin

të cilat konsistojnë në lidhjen e kontratave me kusht dhënien e “paradhënies” gjithsej në vlerën 258,400,000 lekë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjor, duke sjellë si pasojë shkeljen e interesave të ligjshme të shtetit, si dhe urdhëruar dhe paguar më tepër 3,300,000 lekë nga vlera e miratuar për paradhënie nga Ministria e Financave. Po kështu, kallzim penal është bërë për zëvendës drejtorin Skënder Çota dhe drejtorin teknik të ARSH-së, Lefter Kostenia e shefes së sektorit të financës, për likuidimin e Urdhër Shpenzimeve përkatëse të jashtëligjshme.

FONDET

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave të punimeve civile në objektet “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe, Tiranë” dhe “Ndërtim Rruge Kukës-Morinë, Loti 1 (vepra arti të mëdha-dublimi)” nga KLSH është konstatuar se është rritur artificialisht fondi limit në vlerën 24,139,392 lekë (me TVSH) për objektet e mësipërme me pasojë efekte negative në buxhetin e shtetit. Konkretisht, dëmi financiar tek “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe, Tiranë” është në vlerën 19,158,132 lekë (me TVSH) dhe “Ndërtim Rruge Kukës-Morinë, Loti 1 (vepra arti të mëdha dublimi)” në vlerën 4,981,260 lekë (me TVSH).

Shfajësimi

Ish-drejtori i Rrugëve i akuzuar dhe tek Rruga e Kombit

— Gjykata e Lartë ka shpallur vite më parë të pavlefshme zgjatjen e hetimeve nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për dosjen ‘Durrës-Kukës’ për të akuzuarit Armand Teliti, ish-zv/ministër i Transporteve dhe Andi Toma, ish-drejtor Juridik në këtë ministri. Hetimet e Prokurorisë për periudhën 6 nëntor deri në 6 dhjetor 2008 nuk u morën në konsideratë nga Gjykata, pasi rezultuan jashtë afateve që përcaktonte ligji. Sipas Prokurorisë, këta shtetas kishin konsumuar shkelje ligjore gjatë përcaktimit të subjektit, i cili do të ndërtonte rrugën Rrëshen-Kalimash, firmës amerikane Bechtel&ENKA. Ashtu si edhe Lulzim Basha, ministri i tyre, ata përfituan “në tavolinë” për të mbyllur procedimin penal nr. 1, të vitit 2007 dhe për të anuluar vendimin e prokurorit në lidhje me zgjatjen e afatit 1-mujor. Pas kësaj, ai u emërua në krye të Rrugëve.




Marrëveshja

Subjektet pjesëmarrës u morën vesh për të ndarë tenderat

— KLSH ka zbuluar rrezikun e ekzistencës së një marrëveshjeje të ndaluar në oferta për prokurimet publike (kontratat e punëve civile) zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për vitin 2013, pasi konstatohet se, gjatë ofertimeve të njëpasnjëshme, ofertuesit ndjekin parimin e “rotacionit” në të qënurit fitues, element ky i ekzistencës së një marrëveshjeje të ndaluar. Për pasojë, në procedurat e tenderimit të zhvilluara nga ky Autoritet Kontraktor me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore, vërehet se të njëjtët operatorë ekonomikë, të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kriteret të vendosura në DST për secilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta në ofertë është e papërfillshme nga loti në lot.



Nën hetim janë edhe dy zyrtarë të tjerë të Autoritetit Rrugor Shqiptar: ish-nëndrejtori i përgjithshëm Skënder Çota dhe ish-drejtori i Drejtorisë Teknike, Lefter Kostenja



Faksimile e raportit të auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Drejtorinë e Rrugëve

KARRIERE FALE LIDHJEVE ME ARGITA BERISHEN

Andi Toma përfitoi nga 'Studio Pustina'

Administroi fonde rrugësh deri në 400 milionë euro në vit

GENC KONDI
TIRANE

Andi Toma është emëruar që nga viti 2005 drejtor i Departamentit Juridik në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të drejtuar nga kreu aktual i PD-së. Lulzim Basha. Më pas, ai ka zëvendësuar në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Rrugëve Lejla Saraçin, e cila, pasi u largua për rezultate të dobëta në punën e saj, u rimor në punë nga Berisha për kohësisht, vetëm për „karshillëk” ndaj ish-kryeprokurorit Sol-laku, që e kishte shpallur të padehur për abuzim me detyrën shtetërore në tendera. Ajo u risoll në post pas arrestimit të bujshëm të paraardhësit të saj, Ilirjan Berzani, si një nga të dyshuarit kryesorë në ato vite të veprimeve të paligjshme në ndarjen e tenderave të rrugëve nacionale.

fuzuar viza hyrëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga sektori konsullor i Ambasadës amerikane në kryeqytetin shqiptar. Ambasada amerikane, zakonisht, nuk jep asnjë arsye lidhur me shkaqet, që e çojnë atë në refuzimin e vizës

për hyrje ndaj një të huaji. Megjithatë, në kushtet kur ai ishte në proces hetimor të organeve të Prokurorisë, të cilat e akuzonin Tomën për shpërdorim detyre si drejtor në ministrinë e Bashës, vështirë se kërkesa e tij për vizë do të

miratohej. Andi Toma u "katapultua" në një nga drejtoritë kyçe të administratës shqiptare jo për ndonjë meritë të veçantë, por për faktin se vinte nga zyra e avokatit "Studio Pustina", pronë e Laura dhe Andia Pusti-

nës, që kishte jo vetëm lidhje pune me Argita Malltezin (Berisha). Lidhja e fuqishme midis motrave dhe bijës së kreut të Ekzekutivit kishte aq fuqi, sa rezultoi të ketë ndikuar direkt në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Rrugëve.

Andi Toma është bashkëshorti i Laurës dhe kunati i Andias, të dyja shoqe të pandara të Argitës dhe, ndonëse ishte nën hetim zyrtarisht nga organi i Akuzës për shpërdorim të postit zyrtar, lidhur me shkelje të kryera gjatë procesit të tenderimit për rrugën Rrëshen-Kalimash, kjo miqësi ka qenë e mjaftueshme për ta katapultuar atë, nga drejtor departamenti juridik në Ministrinë e Transporteve, në kreun e Rrugëve.

Motrat Pustina kanë patur lidhje tepër të ngushta familjare me bijën e Sali Berishës, që, në gjuhën e përditshme, quhen „hanë e pinë bashkë”. Jo rastësisht Andia mbajti pozicionin e zëvendës-drejtores së përgjithshme të Albelekomit, para se ky të shitej tek turqit e „Çalikut”, e ngarkuar me çështjet ekonomike. Kunata e Andi Tomës ka qenë, njëkohësisht, epërore direkte e Shkëlzen Berishës, pinjollit tjetër të familjes kryeministore, i cili në kompaninë-bijë të paprivatizuar të Albelekomit, „Eagle Mobile”, mbajti postin e drejtorit juridik.

Noterja e skandalit

Laura Pustina, e përmendur në mashtrimin 5.4 mln euro

— Familja e Tomës nuk është hera e parë që del e përfshirë në aktivitetet të dyshimta. Noterja Laura Pustina, shoqja e Argita Berishës dhe gruaja e ish-drejtorit të Rrugëve Andi Toma, rezultoi vitin e kaluar se kishte lëshuar prokurat e përfaqësimit për 11 kompani kineze, që ishin implikuar në skemën e vjedhjes së 5.4 milionë eurove. Prokurorat i janë dhënë shtetasit Mirjan Beneja dhe më pas ky ka kryer shitjet tek bashkëpuntori tjetër Gjergji Tupe. Vjedhja u krye nëpërmjet

një skeme mashtrimi nga zyrtarë të Tatim-Taksave dhe dy biznesmenë, që tani po presin vendimin e gjyqit. Nëpërmjet prokurave të përfaqësimit, është bërë shitja e kapitalit 100 për qind të kompanive tek personi tjetër i përfshirë në vjedhje, shtetasi Gjergji Tupe. Pas kësaj procedure, gjithçka është kryer në drejtorinë e Tatim-Taksave, ku janë miratuar rimbursimet e mbartura të TVSH-së për 11 kompani kineze, rimbursim ky që, sipas Prokurorisë, llogaritet në 5.4 milion euro.



Lidhjet

Në sajë të lidhjeve me familjen e ish-kryeministrit, Andi Tomës iu besua për pesë vjet rresht një fond shumë i madh investimesh nga buxheti i shtetit, që psh vetëm në Buxhetin 2008 llogaritet në mbi 400 milionë euro

BANKA

PROKURORIA në kërkim të parave të vjedhura. Kërkohet destinacioni i shumës prej 713 milion lekëve. Rrugët që po verifikohet nga hetuesit.

Thesari, transfertat me postë ose me bankë

Dyshimi për mundësinë e groposjes së lekëve

ELTON QYNO
TIRANË

Sasia mjaft e madhe e lekëve të vjedhura nga Thesari i Shtetit ka shtyrë grupin e hetimit të dyshojë se paratë janë transferuar jashtë shtetit, tek njerëzit e afërt të Ardian Bitraj, Mimoza Bruzia apo Kleves Bejtaj ose këto para janë gpropusur në tokë.

Nga përgjegjet që kanë mbërritur në njësinë hetimore Task-Forcë nga disa banka të nivelit të dytë, është konfirmuar se në llogaritë e tre personave të sipërcituar ndodheshin sasi të vogla financiare në lek dhe euro. Pavarësisht pas këtyre përgjigjeve pa rezultat, për prokurorinë e Tiranës interes ka nëse nga këto llogari janë kryer transferta bankare dhe se kërkohet nga bankat

e sipërcituar mund të kenë kryer ndonjë dërgesë postare gjatë këtyre katër viteve. Ndërkohë që një tjetër drejtim ku po kryhen hetime është dhe transfertat bankare, ku sipas akuzës tashmë rreth 16 banka të nivelit të dytë në vend, pritet të bashkëpunojnë me prokurorinë për të zbardhur nëse të arrestuarit për skandalin më të madh të BSH, kanë kryer transferta. Dyshimet flasin se

destinacioni i këtyre transferave mund të jetë tek llogaritë e miqve dhe shokëve të tre të ndaluarve.

MUNDËSIA E GROPOSJES

Një tjetër variant që nuk përjashtohet nga prokuroria është dhe mundësia e groposjes nën tokë të thasëve me para të vjedhura nga thesari. Në këtë drejtim, Ardian Bitraj dhe


Mimoza Bruzia janë pyetur nga prokuroria, por asnjëri s'ka pranuar që lekët i kanë fshehur nën tokë. Për prokurorinë gjetja e parave është kthyer tashmë në një mision, pasi sipas burimeve vlera shumë e madhe e vjedhur nga thesari, nuk është luajtur e gjitha në loto dhe kazino, por ka shumë gjasa të jetë transferuar jashtë shtetit ose është fshehur në një vend të sigurt në Shqipëri.



Ardian Bitraj duke hyrë në kasafortë

Pranimi

Në këtë drejtim, Ardian Bitraj dhe Mimoza Bruzia janë pyetur nga prokuroria, por asnjëri s'ka pranuar që lekët i kanë fshehur nën tokë.



Klevis Bejtaj



Objekti i Qendrës së Emissionit të Bankës së Shqipërisë

që të qartësojnë destinacionin real të këtyre transferave. Nga hetimet që ka kryer deri në këto momente organi i akuzës, janë ngritur dyshime të forta se lekët janë nxjerrë jashtë shtetit, dhe se mund të kenë përfunduar në xhepat e miqve dhe të afërme të Ardian Bitraj, Mimoza Bruzia dhe Kleves Bejtaj. Për të faktur këto dyshime, prokuroria veç bankave, ka kërkuar informacion dhe nga zyrat e kompanive private të transferimit të shpejtë të parave. Një tjetër rrugë që prokuroria e kryeqytetit po verifikon me shpresën për të rënë në gjurmët e parave të thesarit të Shtetit, është dhe ajo e postës, pasi ekzistojnë mundësitë që lekët janë dërguar jashtë shtetit me postë.

TRANSFERTA ME POSTË

Për prokurorinë e Tiranës dërgesat me postë, mund të jenë një ndër rrugët që mund të jenë përdorur për të nxjerrë paratë jashtë shtetit. Në shumë raste, me anën e kutive postare janë kryer dërgesa të mëdha parash, pa përjashtuar këtu dërgesa me drogë dhe armë të ndryshme. Duke e konsideruar këtë, si një drejtim që mund të jetë përdorur nga të arrestuarit Ardian Bitraj, Mimoza Bruzia dhe Kleves Bejtaj, prokuroria e Tiranës ka nisur verifikimet për të mësuar nëse personat

AKTIVITETI

Të paraburgosurat luajnë volejball, mungon Golemi

Ish-kryeinspektorja nuk është parë në aktivitetin e zhvilluar në burgun e grave

— Të paraburgosurat e burgut "Jordan Misja" kanë ngritur dje kupën për fitoren e tyre ndaj ekipit të grave të "Ali Demit", në një ndeshje volejbolli të organizuar në kuadër të procesit të rehabilitimit. Në këtë aktivitet të grave të burgosura, nuk është parë prezenca e ish-inspektorës së Përgjithshme të Bankës së Shqipërisë Elivir Golemi, ndërkohë që shumë të paraburgosura femra kanë qënë të pranishme, ku kanë ndjekur ndeshjen e volejbolli. Takimi u organizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në ambientet e burgut "Jordan Misja" ose siç njihet ndryshe me emrin "Burgu 313".

TAKIMI

Takimi u organizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në ambientet e burgut "Jordan Misja" ose siç njihet ndryshe me emrin "Burgu 313".

sisht në shoqëri. Në këtë ndeshje simbolike, nuk mungoi tifozeria e bashkëvuajtëseve të tyre që ndoqën me interes këtë aktivitet. Të gjitha u bashkuan dje në një takim miqësor sportiv, ndryshe nga çdo aktivitet tjetër i mëparshëm, për të provuar gjithashtu edhe emocione të reja. Në fund ndeshja e volejbolli u fitua nga gratë e burgut 313.

VIDEO/ NDESHJA E VOLEJBOLLIT E TË PARABURGOSURAVE

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

DESHMITE

Altin Naqi, këtë javë dëshmi në prokurori

Drejtori Juridik i Bankës së Shqipërisë, thirret nga prokuroria

— Gjatë javës që vjen, mësohet se në prokurorinë e Tiranës pritet të paraqitet dhe drejtori juridik i Bankës së Shqipërisë, Altin Naqe, të cilit i ka

mbërritur fletëthirrja për t'u pyetur për shkak të detyrës që mban. Në fakt, Naqe është paraqitur shpesh në organin e akuzës gjatë këtyre ditëve, ku dhe ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga grupi i hetimit. Sipas akuzës Naqe, do pyetet në cilësinë e personit që ka dënuar për ngjarjen. Sipas rregullores të Këshillit Mbikqyrës Departamenti Juridik i Altin Naqes, kishte për detyrë vetëm të jepte këshilla lidhur me përpilimin nga ana e formës juridike të rregullores, urdhërave dhe akteve të tjera ligjore. Momentalisht e vetmja që nuk është pyetur nga prokuroria e Tiranës, është ish-inspektorja Elivir Golemi, e cila për momentin ndodhet e izoluar në burgun 313 në Tiranë.

OFERTË PUNËSIMI

Një kompani mediatike kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune

Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV-të e tyre në adresën: aurodashkoza84@yahoo.com

VIDEO/ BERISHA-MEKSI PERPLASJA PER DOSJEN "SEKRETE" TE BSH



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas



Ardian Fullani

Në mbrëmjen e datës 5 shtator, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani u vendos nën pranga me akuzën e shpërdorimit të detyrës



Elivar Golemi

Ish-kryeinspektorja e përgjithshme e BSH u arrestua mbrëmjen e datës 5 shtator, pak çaste pas Fullanit, nën akuzën e shpërdorimit të detyrës



Adrian Civici

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Adrian Civici dha dorëheqjen nga posti i tij në datën 9 shtator pas arrestimeve të bëra nga Prokuroria

PRECEDENTET

Berisha: Sekretet e BSH te Rama. Mexsi: Ke fantazi

Anëtarja e BSH: Akuzë politike, raporti mjekësor të jep alibi

ERVIN KOÇI
TIRANE

Ish-kryeministri Sali Berisha ka vijuar përgjatë ditës së djeshme duke akuzuar mazhorancën për arrestimin e bërë ndaj ish-Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullanit. Në valën e akuzave të radhës ishte edhe anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë, Ermelinda Mexsi ku sipas ish-kryeministrit, ajo ka depozituar në Kuvend një kopje të inventarit të pasurisë së Thesarit të Shtetit. Por këto akuzat të Berishës gjetën edhe reagimin e Mexsit e cila i cilësoi këto akuzat si politike dhe fantazira të filmave amerikan.

PËRPLASJA

I pari që hapi debatin përsa i përket akuzave për kopjimin e dokumenteve sekrete të Bankës së Shqipërisë ishte Berisha, i cili nëpërmjet një postimi në faqen e tij në "facebook" theksoi se pesë ditë më parë, Ermelinda Mexsi ka dërguar në Kuvend për fotokopjim dokumentet sekrete të BSH-së. "Sipas burimeve nga Parlamenti, pesë ditë më parë është dorëzuar vjedhas, thuhet nga Ermelinda Mexsi, dhe fotokopjuar në Parlament dosja me sekretet e Bankës së Shtetit, e cila përmban të gjitha kodet, hyrjet dhe daljet sekrete të dhomave të kasafortave ku ruhen thesaret e gurëve, monedhave të çmuara, lingotat e floririt, kartëmonedhat e vendit si dhe vendndodhja dhe inventari i plotë i këtyre të fundit", - theksoi Berisha.

Në reagimin e saj, anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Ermelinda Mexsia i cilësoi këto akuzat si fantazira të filmave amerikan. Ajo theksoi se është anëtare e KMBSH part-time çka bën që ajo të mos ketë akses në asnjë nga dokumentet sekrete të Bankës së Shqipërisë duke shtuar se akuzat e Berishës

ishin me prapavijë politike. "Në mënyrë qesharake një ish-kryeministër, ish-president dhe ende deputet, thotë: "sipas burimeve nga Parlamenti", pyes nga kush në Parlament, nga kryesia, nga fotokopjueseja, apo nga roja tek dera meqë zotëria paska të dhëna se qenkan fotokopjuar? Qenkan fotokopjuar sipas tij sekretet e Bankës. A mos vallë ka parë mbrëmë filmin me Demi Moorin mbi "Bankën e Diamanteve" dhe i doli sot

IRONIA
A mos vallë ka parë mbrëmë filmin me Demi Moorin mbi "Bankën e Diamanteve" dhe i doli sot ne ëndërr


ne ëndërr? Ju zoti Berisha doni të provokoni publikun duke i thënë me gjuhën tuaj të helmuar se vjedhja e ndodhur kur drejtonte Guvernator Fullani nuk ishte asgjë, sepse sipas Jush e gjithë kjo histori ishte që të merrshin kodet e hyrjes dhe pastaj të sulmohet banka nga bandat. Kjo është gjuhë e denjë për një individ që vetëm raporti mjekësor mund ti gjej alibi. Zonja Guvernatore në detyrë: Sqaroje zotin Berisha se anëtarët e KM part-time nuk

kanë akses hyrës në Bankë, kur edhe për të hyrë në mbledhjet e KM duhet të na shoqërojë dikush nga Ju dhe jo më të dimë kodet etj", - tha Mexsi.

Por reagimi i Mexsit bëri që Berisha të dalë me një deklaratë tjetër në faqen e tij në rrjetin social "facebook" duke shtuar se akuzat e bëra deri më tani nga ai vetë kanë dalë të gjitha duke sjellë në vëmendje akuzat për avionët e drogës, vjedhjen e Thesarit të Shtetit në Kërrabë etj.

Ambasadori italian

BSH, Gaiani: Duhet të pritët vendimi i Gjykatës



Massimo Gaiani

— Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Massimo Gaiani deklaroi dje nga Shkodra se qetësia e tregjeve tregon që sistemi bankar është solid dhe funksionon normalisht, duke shtuar se të gjithë duhet të presim vendimin e gjykatës ndaj Guvernatorit Ardian Fullani. Paraditen e djeshme, ambasadori i Italisë në Shqipëri, Massimo Gaiani zhvilloi një takim pune me kryetarin e Bashkisë së Shkodrës Lorenc Luka dhe deputetin e Parlamentit Italian Fabio Porta. Në përgjigje të interesit të mediave lidhur me arrestimin e Guvernatorit Fullani, diplomati Italian tha se duhet të pritët vendimi i drejtësisë dhe se qëndrueshmëria e tregjeve tregon se sistemi bankar në Shqipëri është solid. "Ka një hetim dhe presim vendimin e gjykatës. Nuk mund të them asgjë tjetër, por rëndësi ka pavarësia dhe profesionaliteti i bankës së Shqipërisë, që është një institucion i rëndësishëm. Ajo që mund të them është se

qetësia e tregjeve tregon që sistemi bankar është solid dhe funksionon normalisht", - theksoi diplomati italian në Shkodër. I pyetur mbi bojkotin e opozitës, Ambasadori Gaiani rikujtoi se vendi i dialogut dhe bashkëpunimit është parlamenti, duke shprehur në këtë mënyrë se Partia Demokratike duhet të rikthehet sërisht në parlament. "Kemi ftuar të gjitha partitë politike të punojnë bashkë, të zhvillojnë dialogun. Vendi ku ndërtohet demokracia është parlamenti dhe prandaj ftojme në çdo rast dhe bëjmë apel që ky dialog të përmirësohet dhe të krijohet mundësi për të bashkëpunuar bashkë", - nënvizoi ambasadori Gaiani. Në takimin e zhvilluar me Kryebashkiakun Luka, deputetit I Parlamentit Italian Fabio Porta rikonfirmoi mbështetjen e Italisë për Qytetin e Shkodrës, me projekte të BE-së dhe ngushtimin e bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe bashkive simotra në Itali.

Opozita

Diplomati amerikan theksoi dje në Shkodër se Partia Demokratike duhet që të futet në parlament duke dalë kundër vendimi që ka marrë opozita për të bojkotuar Kuvendin

BRAÇE:

"S'kam besim tek Gjykata e Apelit"

— Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe nëpërmjet një postimi në faqen e tij në rrjetin social "facebook" kërkoi nga qytetarët që të reagojnë pasi nuk kishte besim tek Gjykata e Apelit. Sipas tij, sulmi politik i bërë nga PD-ja lidhur me vendimin për arrestimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë është të bërë presion te Gjykata e Apelit e cila ditën e hënë do të jap vendimin e radhës për Ardian Fullanin dhe Elivar Golemin të cilët aktualisht janë në burg. Braçe ka qenë deputeti i cili e ka ndjekur më shumë çështjen e vjedhjes së BSH.

Gjykimi

Shorti urgjent, Gjin Gjoni largohet për gjithë shtatorin

Alaudin Malaj e Fatmira Hajdari gjykojnë bankierët e arrestuar

ELTON QYNO
TIRANE

Gjyqtari Gjin Gjoni, jo vetëm që nuk do e gjykojë ish-gubernatorin e Bankës së Shqipërisë Ardian Fullani, por i është hequr e drejta për të mos marrë pjesë në asnjë nga proceset e caktimit të masave të sigurisë në Apel, për të arrestuarit e skandalit të vjedhjes së 713 milion lekëve të reja. Njëpërmjet një dispozite ligjore që i jep të drejtën kryegjyqtarit të përjashtojë trupat gjykuese nga një proces penal ose civil, Alaudin Malaj ka urdhëruar që të ngrihen dy trupa gjyqësore, që do shqyrtojnë masat e sigurisë deri në fund të muajit shtator të këtij viti. Një ditë më parë gazeta "Shqiptarja.com" njoftoi se në cilësinë e kryegjyqtarit Alaudin Malaj, ka autoritetin ligjor të ndryshojë gjyqtarët, duke larguar në rastin konkret dy trupa gjyqësore, atë që drejtohej nga Edlira Petri dhe atë që drejtohej nga Gjin Gjoni. Trupa gjykuese e këtij të fundit është përjashtuar deri në fundin e muajit shtator, kohë kur përkon me përfundimin e afatëve të gjykimit të kërkesave të apelit për zyrtarët e arrestuar të Bankës së Shqipërisë.

MBLEDHJA URGJENTE

Është urdhri numër 154 i

Procesi



Malaj

Alaudin Malaj ka shmangur gjyqtarin Gjin Gjoni mjaft të përfolur nga gjykimi i Ardian Fullani. Malaj, ka hyrë vetë në këtë çështje, dhe se pritet që të vendosë për fatin e Fullanit ditën e Hënë në orën 12:00.



Fullani

Njëpërmjet avokatit të tij Maks Haxhia, ish-gubernatori ka pretenduar se është i pafajshëm dhe se ska shkelur asnjë dispozitë ligjore. Haxhia ka deklaruar se arrestimi kryer politikisht.



Gjin Gjoni

kryetarit të Gjykatës së Apelit Alaudin Malaj i lëshuar ditën e Enjte, në orën 15:30 minuta, i cili thotë se po atë ditë në Gjykatën e Apelit është krijuar një mbledhje urgjente, e cila ka vendosur si më poshtë: "Sot më datë 11.09.2014, ora 15.30 u hodh shorti për gjyqtarët që

do të shqyrtojnë masat e sigurimit, duke krijuar dy treshë për dy javët respektive 16-23 Shtator 2014 dhe 23-30 Shtator 2014". E pikërisht në këtë short të hedhur kanë marrë pjesë 15 gjyqtarë. Më tej thotë dokumenti, u përjashtuan nga ky short gjyqtarët e kolegjeve

penale, trupi gjykues i cili ka shqyrtuar masat e sigurimit nga data 1-15 shtator 2014 sipas urdhrit vjetor me ndryshimet e tij, si dhe trupi gjykues i cili po shqyrton masat e sigurimit për periudhën 16-30 shtator 2014 janë zgjedhur gjyqtarët Fatmira Hajdari, Ridvan Hado dhe

Zamir Poda. Katër ditë më parë televizioni "A1 Report" njoftoi se çështja e Ardian Fullanit do gjykohej nga Gjin Gjoni, për shkak se në listën kalendarike të gadishmërisë së gjyqtarëve, Gjoni përkonte me periudhën kur dhe do gjykohej çështja e ish-gubernatorit në Apel.

VIDEO/ JA SI ALAUDIN MALAJ SHMANGU GJIN GJONIN

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

Vendimi në 12:00

Të hënë, Fullani njihet me masën e sigurisë në Apel

— Këtë të hënë, në orën 12:00 në Gjykatën e Apelit Tiranë pritet të zhvillohet seanca për caktimin e masës së sigurisë për ish-gubernatorin e Bankës së Shqipërisë Ardian Fullani. Ky i fundit u arrestua nga policia e kryeqytetit në datën 7 shtator pas një urdhër arresti të lëshuar nga prokuroria e Tiranës. Fullani akuzohet vetëm për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës", pasi gjatë ushtrimit të funksionit të guvernatorit nuk ka nxjerrë një sërë aktesh ligjore, që do të shmangnin vjedhjen e thesahrit të Shtetit.

Vendimi
TIRANE

Zyhdi Dajti nën akuzë zyrtarisht, për bllokimin e bulevardit

Prokuroria dërgon në gjyq dhe tetë inspektorët që firmosën procesverbalet

Ish-kreu i INUK Zyhdi Dajti është marrë zyrtarisht i pandehur për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" lidhur me vendimin për të bllokuar punimet e bulevardit të Tiranës të kryer nga bashkia e kryeqytetit si dhe për rastin e bllokimit të ndërimit të një pallati në rrugën e Elbasanit, objekt ky që po ndërtohet nga Xhuvil Sharxhi dhe Gerti Çalliku. Këta të fundit dy biznesmenët të lidhur ngushtë me Lulzim Bashën dhe bashkëaksionerë me vjehtërin e tij në kompleksin "Jon" në Vlorë, tashmë të rrëzuar me tritol. Mësohet se së bashku me Zyhdi Dajtin, janë vënë nën akuzë për "Shpërdorim detyre" dhe 8 inspektorët Petrit Asllani, Dorjana Ferati, Ismail Kamberi, Ermal Kaçurri, Bledar Aliaj, Elvis Xhaxho, Vilson Dushku dhe Agim Kaloçi. Sipas prokurorëve të njësisë hetimore Task-Forcë, Da-

jti dhe inspektorët e vënë nën akuzë kanë abuzuar me detyrën pasi kanë bllokuar punimet e dy objekteve, në një kohë kur Gjykata Administrative kishte urdhëruar rrëzimin me urdhërit të pezullimit të nxjerrë nga INUK dhe vijimin e punimeve. Por edhe pas këtyre dy vendimeve, INUK që në atë kohë drejtohej nga Zyhdi Dajti ka vijuar të mos lërë bashkinë e Tiranës të kryejë punime në bulevardin e ri si dhe të mos lejojë punime edhe në pallatin 9 katësh që po ndërtohet në rrugën e Elbasanit, nga dy biznesmenët Gerti Çalliku dhe Xhuvil Sharxhi.



Zyhdi Dajti


Akuzat

Së bashku me Zyhdi Dajtin, janë vënë nën akuzë për "Shpërdorim detyre" dhe 8 inspektorët Petrit Asllani, Dorjana Ferati, Ismail Kamberi, Ermal Kaçurri, Bledar Aliaj, Elvis Xhaxho, Vilson Dushku dhe Agim Kaloçi.

Çështja për pasurinë

Gjin Gjoni nëse merret i pandehur, pezullohet nga detyra e gjyqtarit

— Gjyqtari Gjin Gjoni rrezikon të pezullohet nga detyra nëse prokuroria e Elbasanit e merr të pandehur për veprën penale të falcifikimit të dokumentave dhe fshehjes së pasurisë. Me ndryshimet ligjore në ligjin për funksionimin dhe organizimin e KLD, parashikohet se një gjyqtar kur merret në cilësinë e të pandehurit, anëtarët e KLD vendosin pezullimin e tij, deri në momentin kur të merret vendimi gjyqësor i formës së prerë. Disa ditë më parë, burime pranë prokurorisë së Elbasanit informuan se hetimet ndaj Gjin Gjoni, bashkëshortes së tij Elona Çausahaj dhe dy notereve Margena Çela e Gentiana Shkodra janë në fazën përfundimtare dhe se pritet që në fund të muajit



shtator, dosja ti referohet gjykatës së Elbasanit. Burimet shtuan se për këtë çështje janë kryer shumë veprime hetimore dhe se janë marrë dhe deklarimet e personave nën hetim. Tashmë pritet dhe disa veprime dëgjive, për të analizuar faktet, prej nga do të vendoset marja si të pandehur të Gjin Gjoni.

21 janari, Prokuroria vendos nën hetim Kuliçajn e Burgajn

Ish-kryeprokurorja Ina Rama do dëshmojë për braktisjen që ish-drejtuessit i bënë në 21 janar

ELTON QYNO
TIRANË

Mos bindja ndaj urdhrave të prokurorisë së Tiranës për ekzekutimin e 6 mandat-arresteve të lëshuar për arrestimin e efektivëve të Gardës së Republikës pas ngjarjeve të 21 janarit, ka vënë nën hetim dy ish-kreerët më të lartë të Policisë së Shtetit Hysni Burgaj dhe Agron Kuliçaj. Ky i fundit në cilësinë e ish-zv/drejtorit të Përgjithshëm dhe Burgaj në cilësinë e drejtorit, zyrtarisht janë vënë nën hetim nga prokuroria e Tiranës për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës". Burimet thanë se Burgaj dhe Kuliçaj, i janë shënuar emrat në regjistrin e procedimeve penale, çka do të thotë se dy ish-policët e lartë janë vënë nën hetim për skandalin e refuzimit të ekzekutimit të urdhrave për arrestimin e Ndreja Prendit dhe 5 gardistëve të tjerë, të dyshuar në atë kohë nga organi i akuzës se kishin qëlluar me armë mbi protestuesit e opozitës.



Agron Kuliçaj

në atë kohë, është vlerësuar që dy emrat e mësipërm të vihen nën hetim, duke u konsideruar si dy persona që janë të dyshuarit kryesor në këtë çështje. Momentalisht Hysni Burgaj është dorëhequr nga policia ndërsa Agron Kuliçaj, pas dorëheqjes punon si këshilltar i PD në grupin parlamentar. Pritet që në ditët në vijim prokuroria e Tiranës të thërrasë për të marrë në pyetje dy ish-kreerët e lartë të Policisë dhe ish-kryeprokurorin Ina Rama.

PYETJA E PROTAGONISTËVE

Pak kohë më parë prokurori Ndini Tavani, nisi verifikimet për këtë çështje duke u vënë në lëvizje nga një kallëzim i SHKB. Mirëpo siç mësohet, pas mbërritjes në prokurori të gjithë korrespondencës që është kryer mes policisë dhe prokurorisë

"URDHËRI ME GABIME"

Pavarësisht situatës tejte të rënduar, dy ditë pas 21 janarit ish-kryeprokurorja Ina Rama arriti të komunikonte në telefon direkt me kreun e Policisë së Shtetit në atë kohë Hysni Burgaj, duke i kërkuar këtij të

fundit arsyt pse nuk ekzekutohe urdhrat e ndalimit për 6 gardistët. Nga ana e tij, Burgaj i është kundërpërgjigjur se nuk mund të vepronin në kushtet kur vartësit e ish-kryeprokurorës kishin dërguar në polici, një urdhër ndalimi me gabime ortografike dhe adresa të gabuara. Një ditë më pas, ka reaguar Edi Rama, në atë kohë shefi i opozitës që drejtonte protestat, duke i kërkuar zyrtarisht policisë, që të linte menjëherë ndërhyrjet të politikës dhe të zbatonte ligjin duke iu bindur prokurorisë. Fill pas tij, ka reaguar ashpër deri në fyerje personale ish-kryeministri Sali Berisha, duke e quajtur ish-kryeprokurorin Rama si lavire bulevardi ndërsa Edi Ramën horr bulevardit. Mes Hysni Burgajt dhe Agron Kuliçajt, në kallëzimin e SHKB janë dhe dy prokurorë, që, sipas drejtuesve të SHKB, në atë kohë nuk kanë marrë masat e nevojshme për të zgjidhur situatën dhe ndaluar 6 gardistët. Sipas SHKB, prokurorët duhet të nisnin menjëherë hetimet për Burgajn dhe Kuliçajn, dhe për këtë si indicie ka qenë dhe një kallëzim penal i bërë në atë kohë nga PS. Ndërkohë që në fund të kallëzimit, SHKB i ka kërkuar prokurorisë të marrë në pyetje disa persona, mes të cilëve dhe ish-kryeprokurorin Ina Rama. Ndërsa si prova materiale janë referuar të gjitha shkresat e korrespondencës për atë ngjarje.



NË FOTO: Ish-kreu i Policisë Hysni Burgaj

6 gardistë

Ish-kryeprokurorja Ina Rama ka lëshuar 6 mandat-arresti duke i kërkuar policisë ekzekutimin me tyre. Mirëpo, ndryshe nga siç parashikon ligji, urdhëri nuk është zbatuar me vendim të Burgajt dhe Kuliçaj.

4 persona

Ky është bilanci i personave që mbeten të vrarë në bulevard gjatë demonstratës së 21 janarit. Veç Ziver Veizit, Hekuran Dedës, Aleks Nikës dhe Faik Myrtaj, që mbeten të vrarë, u plagosën dhe shtatë persona të tjerë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Kontrolli i Lartë i Shtetit rihap procedurën e pranimit në shërbimin civil për vende të lira pune, në vazhdim të njoftimit të datës 15 gusht 2014 dhe të konkursit që u zhvillua me datat 15-16 gusht 2014 nga i cili rezultuan fitues me pak kandidatë nga sa ishin parashikuar.

I. Për 2 (dy) vende në pozicionin e Audituesit në Departament Auditimit. Kërkesat për kandidatët e këtyre vendeve të punës janë:

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar jo më poshtë se Niveli DND në Ekonomik apo Financë.
- Të ketë eksperiencë pune në fushën përkatëse.
- E detyrueshme zotërimi i gjuhës angleze me dëshmi si dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.
- Do të favorizohen kandidatët që zotërojnë certifikata si Ekspert Kontabël apo Auditues i Brendshëm.
- Të zotërojnë programet bazë të kompjuterit; teknikat CAAT në Auditim si dhe programet e Mbatjes së Kontabilitetit Alpha/Financa.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese për të punuar në grup.
- Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

II. Për 1 (një) vend në pozicionin e Audituesit në Departament Auditimit. Kërkesat për kandidatët e këtyre vendeve të punës janë:

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar jo më poshtë se Niveli DND për Drejtësi
- Të zotërojnë njohuri në fushën përkatëse të diplomimit.
- E detyrueshme zotërimi i gjuhës angleze me dëshmi si dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.
- Të zotërojnë programet bazë të kompjuterit; teknikat CAAT në Auditim si dhe programet e Mbatjes së Kontabilitetit Alpha/Financa.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese për të punuar në grup.
- Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

III. Për 2 (dy) vende në pozicionin e Audituesit në Departament Auditimit. Kërkesat për kandidatët e këtyre vendeve të punës janë:

- Të ketë kryer arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar jo më poshtë se Niveli DND në degën nxhineri Informatike, Informatike Ekonomike, Jnhxineri Elektrike.
- E detyrueshme zotërimi i gjuhës angleze me dëshmi si dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.
- Të zotërojnë programet bazë të kompjuterit; teknikat CAAT në Auditim si dhe programet e Mbatjes së Kontabilitetit Alpha/Financa.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese.Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

Përkrahimi i punës

Kryen në mënyrë ligjore, profesionale, etike dhe brenda afateve të përcaktuara detyrat Audituese. Zbaton programin e auditimit, ndërsa për problemet që nuk janë përfshirë në programin e auditimit, ia ben prezent përgjegjësit të grupit të auditimit. Gjykon për nivelin e materialitetit e të rrisht. Gjatë veprimtarisë audituese harton dokumentat e auditimit. Gjithashtu, në bashkëpunim me përgjegjësin e grupit të auditimit harton projekraportet e auditimit, pasqyrojnë me shkrim sgarimet për vlerëjet e bëra nga subjekti i audituar. Gjithashtu harton raportet përfundimtare të auditimit dhe projektvendimet përkatëse. Plotëson dhe nënshkruan statistikat e kontrollit, si evidencën e kostos, evidencën e zbulimeve, të masave të propozuara dhe gjithë dokumentacionin e auditimit. Në përgatitjen e materialeve të auditimit zbaton dhe mban përgjegjësi për afatet kohore të parashikuara. Jep mendime për përmirësimin e punës së departamentit e të institucionit, si dhe për ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore, të cilët ai i çmon të arsyeshme. Paraqet çdo 3-mujar raportin e aktivitetit të tij përpara drejtorit të departamentit.

Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët duhet të paraqesin në Drejtorinë e Burimeve Njerezore deri në datë 26 Shtator 2014 keto dokumente: Letër motivi për aplikimin në vendin vakant, CV-në, kopje të diplomës së shkolles së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, kopje e listës së notave dhe librezës së punës të notëzuarra, fotokopje e letërnjoftimit, rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaliteti, si dhe dokumente të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejnjë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale si dhe dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja, të cilat do të verifikohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim.

Konkurrimi

Kandidatët që do të plotësojnë kriteret e verifikimit paraprak do t'i nënshtrohen provimit të gjuhës angleze 3 ditë përpara zhvillimit të testimit me shkrim. Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", ligjin nr. 9131, datë 8. 9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standardet e kontrollit të KLSH" dhe "Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, mbi njohuritë dhe të dhënat që jepen në serinë e botimeve të KLSH-së ~ 2012-2014, si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së në internet". Një pjesë e konsiderueshme e konkursit do të zhvillohet në gjuhën angleze. Në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, eëe.kish.org.al, me datë 28 shtator 2014 do të shpallet edhe lista e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe datat e zhvillimit të konkursit.

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Në selinë e re

Berisha takime në PD me të pakënaqurit e Bashës

— Ndryshimet në statutin e Partisë Demokratike, si dhe mbledhja e Kuvendit të kësaj partie në fund të muajit shtator, kanë sjellë dhe një intensifikim të takimeve mes ish-kryetarit të selisë Blu Sali Berisha me ata që njihen si deputet kundërshtar të Lutizim Bashës. Burimet kanë bërë të ditur se qëllimi i bisedave ka qenë marrja e mendimeve mbi pika të ndryshme të ndryshimeve

në statutin e selisë blu, por dhe formës që do të vendoset për kandidatët dhe votimin e Këshillit Kom-bëtar të selisë blu. Po ashtu përcaktimet mbi kryesinë e re apo departamentet e PD-së mendohet se kanë qenë objekt i takimeve. Por ndryshe nga një javë më parë, këtë herë Berisha i ka nisur takimet në ambientet e selisë Blu, ku tashmë ai ka marrë një zyrë të posaçme.



MESAZHET drejtuar opozitës për rikthimin në Parlament kanë qenë të vazhdueshme gjatë këtyre dy muajve si nga kryeparlamentari Meta ashtu edhe nga kryeministri Rama



Kryetari i Kuvendit Ilir Meta dje në Berat

Ftesa
Kryeparlamentari i është drejtuar opozitës me ftesën për të qenë tolerantë dhe të bashkuar duke theksuar se vetëm bashkëpunimi dhe toleranca do ta çojnë Shqipërinë përpara

Ngjarjet

10 Korrik

Shënon edhe ditën e fundit të opozitës në Kuvend. Si pasojë e një konflikti mes deputetit socialist Arben Noka dhe atij demokrat Gent Strazimiri, opozita vendosi të braktisë punimet e parlamentit.

1 Shtator

Kreu i PD, Lulzim Basha deklaroi vendimin e opozitës për vijim të bojkotit, pavarësisht qëndrimit të kundërt nga aleatët dhe deputetë të vetë opozitës.

LAJME shkurt



PD: Daja i Veliajt pallat pa leje. Kryebashkiaku s'pranon akuzat

— Ndërtimi i një objekti në Urën Vajgurore është bërë pjesë e replikave mes PD-së dhe kreut të kësaj Komune. PD ka vijuar me akuzat ndaj Ministrisë, Erion Veliajt dhe familjarëve të tij për ndërtimin e objekteve pa leje. Ervin Saliqiu denoncoi dje, në emër të PD, një ndërtim në Urën Vajgurore, i cili sipas tij është në pronësi të dajës së ministrit Veliajt dhe është pa leje. Saliqiu theksoi se pallati në pronësi të dajës së Veliajt, që është njëkohësisht edhe Kryetari i Bashkisë së Urës Vajgurore, është në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Saliqiu përmendi dhe faktin se ndërtimi është bllokuar prej 3 vitesh, për t'i rinisur punimet vetëm para 6 muajsh, pas ndërrimit të qeverisë. Ndërkohë që në lidhje me akuzat ka reaguar vetë kreu i Bashkisë së Urës Vajgurore Syrja Omeraj, duke sqaruar edhe pronësinë e ndërtesës në fjalë. Omeraj, në deklaratën e tij është shprehur se nuk ka në pronësi asnjë ndërtesë të tillë në qytetën e Urës Vajgurore dhe se objekti që u përmend nga Saliqiu është në pronësinë e gruas së vëllait të tij, që kur ky i fundit ka ndërruar jetë. Kreu i Bashkisë së Urës Vajgurore deklaroi gjithashtu se po ndjek në shkallët e larta ligjin dhe do të jetë në mbështetje të të afërmeve të tij, sidomos në rrethanat në të cilat ndodhet kumata e tij.

Meta i zgjat dorën opozitës dhe e fton sërish në Kuvend

Kryeparlamentari thirrje Bashës gjatë festës së çlirimit

JUXHIN MUSTAFARAJ
BERAT

Kryetari i Kuvendit Ilir Meta i ka bërë sërish ftesë opozitës për të qenë pjesë e jetës parlamentare. Pas mungesës dy mujore në parlament dhe debateve të ashpra në distancë, kryeparlamentari Meta ka shfrytëzuar festimin e 70 vjetorit të çlirimit të Beratit për t'i bërë thirrje Bashës për bashkëpunim. "Vetëm bashkëpunimi dhe toleranca do ta çojnë përpara Shqipërinë", u shpreh Meta nga Berat ku mori pjesë në festimet e zhvilluara për 70-vjetorin e Çlirimit të vendit. Sipas kreut të Kuvendit është e nevojshme që debati dhe pakënaqësitë që forcat politike kanë ndaj njëri-tjetrit ta zhvillojnë në komisionet parlamentare dhe sallën e Parlamentit. Mesazhet drejtuar opozitës për rikthimin e tyre në Parlament kanë qenë të vazhdueshme gjatë këtyre dy muajve si nga kryeparlamentari Meta ashtu edhe nga kryeministri Rama. Së fundmi kreu i qeverisë Edi Rama kërkoi bashkëpunimin e opozitës për realizimin e reformës në drejtësi, reformë që është shpallur edhe si guri i fortë i këtij sesiioni parlamentar për mazhorancës. Ndërkohë, opozita, nga ana e saj, nuk ka ndërmend të kthehet shpejt në parlament, tani që në selinë e re ka krijuar edhe komisionet me deputetë e djathtë që dublojnë paralelisht ato që zhvillohen në kuvend. Vendimi i opozitës për braktisjen e Parlamentit erdhi menjëherë mes konfrontimit fizik që pati mes deputetit të Partisë Socialiste Arben Noka dhe deputetit demokrat Gent Strazimiri. Kreu i opozitës Lulzim Basha i oftoi në 1 shtator, ditën e rifillimit të sesionit të ri parlamentar se opozita do të vijoj me bojkotin e Parlamentit deri në momentin që kryemin-

istri dhe mazhoranca të distancohen nga akte të dhunshme si ai që ndodhi me deputetin Strazimiri. Në theyerje të vendimit të opozitës, deputeti Nard Ndoka ka qenë prezent këtë të enjte në seancë plenare ku ka pasur edhe një incident mes tij dhe kryeparlamentarit Meta, pasi sipas Ndokës ky i fundit

refuzoi t'i jepte fjalën edhe pse ai e kishte kërkuar. Kryeparlamentari Meta gjatë takimit që pati në Berat përcollti edhe urimet për festën e çlirimit dhe vlerësoi kontributin që Berati ka dhënë në Luftën Nacional Çlirimtare. "Berati di t'i festojë ngjarjet si asnjë qytet tjetër", tha Meta.

VIDEO/ META APEL OPOZITËS PËR NË PARLAMENT
Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shtrikohet falas

Toponimet, PDIU paralajmëron interpelancë me Bushatin

Idrizi: Qeveria s'kishte detyrim përdorimin e emrave të huaj



Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet do të thërrasë në interpelancë plenare Ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati për çështjen e toponimeve. Edhe pse PDIU vijon të qëndrojë në opozitë, në kundërshtim me vendimin politik të kreut të opozitës Lulzim Basha për bojkot të Parlamentit, ka deklaruar se do të jetë të jetë pjesë e parlamentit. Megjithatë mazhoranca e ka konsideruar zgjidhjen e çështjes së toponimeve si një sukses pas problemeve të shumta që u përballën emigrantët në kufi, PDIU ka ngritur pretendime në lidhje me arsyen e shkrimit në gjuhë të huaj të emrave në pasaportat e shtetasve shqiptarë. Kryetari i PDIU Shpëtim Idrizi është shprehur se bashkë me grupin e tij parlamentar do të jenë pjesë e punimeve të Kuvendit dhe do të kërkojnë interpelancë me ministrin Bushati për t'i kërkuar arsyet e marrjes së vendimit për shkrimin në gjuhë të huaj të emrave të shtetasve shqiptar në pasaportat e tyre. Një prej argumenteve

që PDIU pritet të përdorë lidhur me këtë çështje pritet të jetë fakti që edhe vetë Nënkomisioni i Gjeografisë në OKB, nuk e ka si kusht vendosjen e emrave në gjuhë të huaj në pasaportat e shtetasve shqiptarë. "Mendojmë se nuk është e arsyetur që kur shqiptarët, Janinës i thonë Janinë, në pasaportat e shtetit shqiptar apo në pasaportat e shtetasve shqiptarë, që mund të kenë lindur në Greqi, ne të jemi të detyruar ta shkruajmë Ioannina apo Thessaloniki", sqaroi Idrizi. Sipas kreut të PDIU, shteti shqiptar është përballur me shtetin grek në Nënkomisionin e Gjeografisë në OKB për çështjen e shkrimit të emrave, dhe duke pranuar kërkesën e shtetit

grek ka zgjedhur versionin e tyre për shkrimin në gjuhë të huaj të emrave në pasaporta. PDIU së bashku me një grup pune është duke përgatitur të dhënat të cilat sipas të gjitha gjasave do t'i paraqes në interpelancë me ministrin Bushati në Parlament. "Ne rezervojmë të drejtën të kërkojmë një interpelancë me Ministrin e Jashtëm për ta sqaruar edhe për opinionin publik e duke qenë akoma më shumë të vëmendshëm për faktin se kjo histori ka lindur me shqiptarët e Çamërisë, kryesisht me ata në moshtë të thyer, të cilët kanë lindur në Çamëri dhe që në vendlindjen e tyre kanë shkuar pikërisht vendin ku kanë lindur: Margëlliç, Filat, Pargë, Paramithi", deklaroi Idrizi.

Bylykbashi: Qeveria konkurse të paligjshme

— Deputeti demokrat Oerd Bylykbashi i ka konsideruar si të paligjshme ndërhyrjet e qeverisë në ligjin e nëpunësit civil. Në një reagim në media, Bylykbashi e cilësoi vendimin për kalimin e dosjeve personale në administratë si një fshesë dhe kanosje që qeveria po i bën administratës publike. Lidhur me konkursat për vendet vakante në administratë, deputeti i PD u shpreh se vetë ligji është shpreh qartë se në momentin që ka nëpunës në listë pritje nuk mund të hapen konkurse të reja.

Zgjedhjet

Grupi i punës për zgjedhjet, është një ndër 4 grupet që kreu i PS-së, Edi Rama ngriti në mbledhjen që zhvilloi me deputetët e majtë në Durrës në fund të gushtit

Takimet

Grupi i punës i përbërë nga tre deputetë do t'i rikthejë në një ritual të përvajshëm takimet me elektoratin në qytete të ndryshme të Shqipërisë.



Fondi

SHBA, 28.5 mln dollar për qeverinë shqiptare

SHBA ka akorduar një ndihmë financiare prej 28.5 milion dollarësh në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri. Shuma që i ka kaluar qeverisë shqiptare është në kuadër të një marrëveshje ndihme që është lidhur mes qeverisë shqiptare dhe asaj amerikane në 30 shtator 2013 që ka për synim shtetin e së drejtës dhe një qeverisje më të mirë. Ndihma financiare akorduar nga SHBA do të shpërndahet nëpërmjet kësteve nëpërmjet viteve 2013-2016. Më 30 qershor 2014, mes palës shqiptare dhe asaj amerikane, është nënshkruar ndryshimi nr.2 i kësaj marrëveshje, e cila së fundi ka mbërritur për ratifikim në parlament. Duke iu referuar këtij dokumenti është paracaktuar se palët do të zbatojnë projektet me interes të përbashkët dhe për financimin e tyre i është akorduar qeverisë shqiptare për vitin fiskal 2013 një grand që nuk e tejkalon vlerën e 9 milion e 906 mijë USD. Pjesa tjetër e kontributit total prej 28 milion e 544 mijë dollarësh do të jepet me shtesa dhe në bazë të disponueshmërisë së fondeve nga USAID. Shuma e akorduar për qeverinë shqiptare do të vihet në zbatim në fusha si shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut, qeverisje më të mirë, shoqërië civile, tregti dhe investime dhe konkurrueshmëri.

PS nis grupin e punës në terren për zgjedhjet e 2015

Takime me bazën për të nxjerrë problematikat e nisjes së garës

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Partia Socialiste nisi dje punën për përgatitjen në zgjedhjet e pushtetit vendor, që do të mbahen vitin e ardhshëm. Grupi i punës që po merret me angazhimin elektorat të partisë i cili drejtohet nga sekretari organizativ në këtë parti Blendi Klosi, ka zhvilluar takimet e para këtë fundjavë në Korçë dhe Dibër. Gjatë këtij takimi Klosi shoqërohej nga deputetët e tjerë të këtij grupi pune Musa Ulqini dhe Blerina Gjylameti me të cilët ka dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet nga baza. Burime për "Shqiptarja.com" bëjnë me dije se gjatë takimeve të zhvilluara deputetët socialist kanë marrë sugjerime edhe për procedurat që do të ndiqen në arrijtjen e listave për kandidatët për këshilltarë bashkiakë, si dhe për kandidatët e Bashkive. Takimet e zhvilluara dje në rrethin e Dibërës nga ky grup pune ka

qenë në funksion të përgatitjes që PS po bën për zgjedhjet lokale. Këto takime do të kthehen në një ritual të përvajshëm nga ky grup pune deri në zgjedhjet e 2015-ës. Nga këto takime me bazën të deputetëve Klosi, Ulqini dhe Gjylameti pritet të arrihet në gjetjen e problematikës së çdo zone, situatën e degëve si dhe në gjetjen e formulës së duhur në përzgjedhjen e kandidatëve. Grupi i punës që po merret me angazhimin elektorat të partisë i nisi takimet me strukturat në Korçë të premten. Ndërsa rezultatet e takimeve dy ditore pritet t'ia referojnë kryetarit të PS-së gjatë mbledhjes së grupit ditën e hënë në PS.

GRUPET

Grupi i punës për zgjedhjet, është një ndër 4 grupet që kryeministri dhe njëherësh kreu i PS-së, Edi Rama ngriti në mbledhjen e parë informale që zhvilloi në fund të gushtit me deputetët e majtë, takim i zhvilluar në Durrës. Gjatë javës që lamë pas deputetët



Në grupin e punës për angazhimin elektorat të PS bëjnë pjesë deputetët Blendi Klosi, Blerina Gjylameti dhe Musa Ulqini

e angazhuar në grupin e punës për cilësinë e legjislacionit, Fatmir Xhafta, Armando Subashi dhe Ermonela Felaj janë angazhuar që pas mbledhjeve të Komisionit të Ligjeve të diskutojnë për secilin ligj që qeveria propozon për kalim në komisionet parlamentare. Rishikimi i draft-propozimeve të ardhura nga qeveria nga ky grup pune ishte një domosdoshmëri pas kthimit të disa ligjeve që komisionet parlamentare bënë sesionin e shkuar. Në të njëjtën kohë deputetët e grupit të punës që po merren me cilësinë e punësimeve në administratë Taulant Balla, Namik Kopliku dhe Majlinda Bufi kanë bashkërenduar punën për të rishikuar çdo punësim që po kryhet në nivelet e administratës. Puna ka filluar edhe në grupin e punës që do të merret me rregullimin e marrëdhënieve deputet-qeveri, pjesë e së cilit është Erion Braçe, Erion Veliqaj dhe Eduard Shalsi duke shmangur situata si ato të një sesioni më parë ku disa prej deputetëve refuzuan të votonin ligjet e mazhorancës në kuvend.

Rama prezanton modelin e ri ekonomik në Kinë

"Qeveria shqiptare partnere me biznesin"

Kryeministri Rama në vijim të vizitës së tij në Kinë ka prezantuar përpara sipërmarrësve kineze modelin e ri ekonomik në Shqipëri. Kreu i qeverisë njoftoi vetë nëpërmjet një postimi në "facebook" mbi takimin që zhvilloi dje në Shanghai me një sipërmarrje të madhe kineze. "Në Shanghai me sipërmarrje të mëdha kineze për të prezantuar Shqipërinë që po rilind, modelin tonë të ri ekonomik, qeverisjen partnere të biznesit dhe për t'u njohur me interesat, prioritetet si edhe kërkesat e tyre", ka shkruar kryeministri Rama. Takimin e tij disa ditore në Kinë, kreu i qeverisë e ka shfrytëzuar edhe për të ftuar investitorët e interesuar



kinezë për të interesuar në vendin tonë. Në vizitën e tij në Kinë, kryeministri Rama ka zhvilluar një sërë takimesh të cilat kanë qenë të përqendruara në projekte ekono-

Investimet

Projektet që qeveria kineze pritet të investojë në Shqipëri janë ato për Rrugën e Arbrit, Hekurudhat shqiptare, Portin e Shëngjinit dhe Korridorin e Kaltër

mike dhe infrastrukture të cilat Kina pritet t'i investojë në Shqipëri. Gjatë takimit të zhvilluar me homologun e tij kinez Li Keqiang, Rama mori mbështetjen për financimin nga qeveria kineze të 5 projekteve të rëndësishme në vendin tonë. Sipas një deklaratë të dhënë nga kreu i qeverisë Rama, në radion shtetërore "CRI", qeveria kineze pritet të investojë në Shqipëri në Hekurudhat shqiptare, "Rrugën e Arbrit", Portin e Shëngjinit dhe Korridorin e Kaltër. Rama në këtë vizitë shoqërohej nga ministri Ahmetaj, Nikolli dhe krerët vendor të Durrësit dhe Kavajës.



FOTOLAJM

RAMA NË LARTËSINË E KULLAVE TË SHANGAIT

Kryeministri Edi Rama ka postuar dje në "facebook" një foto në të cilën shfaqet në lartësinë e një ndërtese në Pekin. Gjatë vizitës së tij në Kinë, kreu i qeverisë ka zhvilluar një sërë takimesh të cilat kishin në qendër ekonominë dhe investimet.

Ceremonia
DURRËS

“Albanian Lion 14”, Kodheli: NATO, veprimet në çdo kohë

Rikthehet baza e “Kepit të Palit”. Në stërvitje dhe Nishani

Baza detare e “Kepit të Palit” (Bisht-Pal-la) i është rikthyer funksionit të saj të vjetër, pas një periudhe të gjatë të lënies në harresë. Ndonëse e amortizuar deri në shkëlqim, ajo ka qenë arena e stërvitjes ndërkombëtare me trupa shqiptare e britanike. Ideja e stërvitjes ishte zbkarkimi i forcave komando angleze në territorin shqiptar në funksion të mbrojtjes së bazës nga një sulm i forcave terroriste. Në ceremoni morën pjesë Presidenti i Republikës Bujar Nishani, ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar Nikolas Canon, përfaqësues të trupit diplomatik, dhe ushtarakë e të ftuar të tjerë. Ministria Mimi Kodheli theksoi se stërvitja në një situatë të brishtë për sigurinë në kontinentin tonë duke marrë parasysh zhvillimet dhe aktivitetet e dhunshme në lindje të Ukrainës prej Federatës Ruse si dhe aneksimi i Krimesë. Kodheli tha se “Shqipëria është e gatshme të veprojë kudo e kurdo si partner i përgjegjshëm i NATO-s”. “Luani Shqiptar 2014” që bëhet në vendin tonë është tregues i madhësisë dhe rëndësisë së saj. Përfitimimi më i madh është konsolidimi i miqësisë mes dy forcave

Angazhimi



Terrorizmi
“Terrorizmi e fundamentalizimi, që kanë ekzistuar, po kapërcejnë çdo limit, po shkëlqojnë çdo parim themelor dhe vlerë universale. Ne nuk mund të lejojmë që kjo situatë të vazhdojë”.



Presidenti
Nishani shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe kontributin e spikatur që Britania e Madhe i ka dhënë Shqipërisë në të gjithë këto 102 vjet përjekje të ndërtimit të shtetit.



Shtirirja

Kjo stërvitje po zhvillohet në disa rajone në vendin tonë si në Bizëz, Zall-Herr, Kepin e Palit, Kuçovë, Pashaliman dhe Porto Palermo, si dhe u mbështetën nga deti me 4 anije ushtarake.

Rinas/Sot

Tjetër stërvitje e përbashkët me trupat britanike

— Nuk mbaroi në Kepin e Palit stërvitja e përbashkët. Sot, në mjediset e Aeroportit të Rinasit, pjesa ushtarake, zhvillohet Dita e Hapur, në kuadër të stërvitjes së përbashkët shqiptaro-britanike “Albanian Lion 2014”. Të pranishëm në këtë ceremoni do jenë zv.ministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, generalmajor Jeronim Bazo, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, Nicholas Cannon, generalë e ushtarakë të lartë të FA, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë etj.

TIRANË/PAPA

Vatikani s’pranon Thaçin në takimeve

— Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi ka kërkuar nga autoritetet e Shqipërisë që gjatë vizitës së Papa Françeskut në Tiranë, më 21 shtator, t’i mundësohet që të jetë pjesë e agjendës zyrtare të takimeve. Sipas gazetës Express, Vatikani ka hedhur poshtë mundësinë që edhe Hashim Thaçi të jetë pjesë e agjendës së takimeve zyrtare të Papa Françeskut me autoritetet në Tiranë. “Thaçi ka kërkuar që të jetë pjesë e takimeve që Papa do bëjë në Tiranë. Zyrarist është kontaktuar Vatikani dhe nuk ka pranuar që ai të jetë pjesë”, shkruan gazeta Express.

tona të armatosura. Stërvitja “Luani Shqiptar” po zhvillohet në kohë të brishtë për sigurinë e kontinentit evropian. Shqipëria ka dënuar prej fillimit agresivitetin e Rusisë dhe iu është bashkuar pozicionimit të aleatëve. Terrorizmi dhe fundamentalizmi po kapërcejnë çdo limit. Shqipëria veprimet shpejt duke mbështetur qeverinë e Irakut. Ne kemi treguar se jemi të gatshëm të veprojmë kudo e kudo si partner i përgjegjshëm”, deklaroi ministria Kodheli. Duke folur për samitin e

NATO-s që u mbajt në Uells, ajo tha se “Një javë më parë pata privilegjin, që në përberje të delegacionit shqiptar të kryesuar nga Kryeministri i Shqipërisë, të merrja pjesë në Samitin e NATO, Uells, në Mbretërinë e Bashkuar. Ky samit do mbetet në historinë e Aleancës tonë, si samiti ku edhe njëherë me zë të fortë dhe të unifikuar u bë e qartë se Aleanca është e bashkuar, e fortë dhe e gatshme të mbrojë secilin vend anëtar të saj”. Presidenti Bujar Nishani në fjalën e tij komentoi

edhe ngjarjet që zhvillohen në Mesdheun Lindor dhe në lindje të Ukrainës, të cilat janë dëshmi se për sigurinë dhe paqen kërkohet aleancë me forcat më demokratike dhe sigurinë, siç është Aleanca e Atlantikut të Veriut. “Aleanca e Atlantikut të Veriut e ka tejkaluar me sukses “sovrانيتin territorial të hapësirës euro-atlantike”, deklaroi Presidenti i cili mori pjesë në këtë stërvitje. Aleanca jonë e përbashkët është shpresa e paqes dhe lirisë në të gjithë globin”. Më pas

të pranishmit kanë ndjekur një demonstrim të forcave komande britanike dhe shqiptare me veprime nga ajri, deti dhe toka për eliminimin e një grupi të rrezikshëm terroristësh. Sot ishte dita e mbylljes së stërvitjes së përbashkët britaniko-sh-

qiptare e quajtur “Albanian Lion 14”, e cila fokusohet në kryerjen e operacioneve të evakuimit të civilëve, “Non-Combatant Evacuation Operations”, nëpërmjet operacioneve detare, tokësore dhe ajrore. Në këtë stërvitje kanë marrë pjesë rreth 600 trupa.

At Nikolla Marku:

“Ja pse Janullatos s’duhet të takojë Papa Françeskun”

— At Nikolla Marku e ka cilësuar eveniment të jashtëzakonshëm vizitën e Papa Françeskut në 21 shtator në Shqipëri. Këtë ai ke vlerësuar si meritë të bashkëjetesës fetare që mbizotëron në vendin tonë. At Nikolla Marku ka sulmuar sërish kryepeshkopin Anastas Janullatos se ai nuk ka asnjë kontribut për bashkëjetesën fetare në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë për ortodoksinë shqiptare. “Ne emër të kujt do ia japësh dorën të Janullatos, Papa Françeskut, ti përfaqëson Kishën e Ortodokse të Shqipërisë. Kur ti je stërnipi i Kozmait famëkëq të Thanait të Greqisë. Me dritë të zeze që i futi shqiptarët në vëllavrasje me njëri-tjetrin. Me metoda korruptive dhe me hutim



të mendjes e me mallkim të gjuhës shqipe”, tha At Nikolla Marku, Famulltar i Kishës Shën Mëria, Elbasan përfaqësues i Kishës Ortodokse autoqefale Shqiptare. Marku tha se gazetat dhe qarqet shoviniste greke kërkojnë ta tjetërsojnë këtë bashkëjetesë së bashku me partinë naziste “Agimi i Artë” kërkojnë të nxijnë bashkëjetesën fetare në Shqipëri.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti i kërkesës është Komuna Trebisht. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për ndërtimin e rrugës Trebisht – Doganë në Komunën Trebisht është 494 112 (katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1 javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatës në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Lista e emërora e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të ndërtimit të rrugës Trebisht-Doganë, ZK 3630

Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja, m ² që shpronësohet	Cmimi lekimi	Livadi m ²	Cmimi	Pemë Ara	Cmimi	Plepa	Cmimi	Vlera totale	Konfirmimi nga Z.V.R.P.P.
1	Asllan Selen	474/1	3630	760	124					5	1700	94240	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
2	Ibrahim Tafaj	475	3630	490	124							9920	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
3	Haki Sallia	492	3630	390	124	570	74	5	4500			109320	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
4	Artan Shahinaj	320	3630	168	124			5	4500			43332	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
5	Rustem Cereni	325	3630	1200	124			2	4500			157800	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
6	Asllan Kanxha	576	3630	150	124					3	1700	23700	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
7	Qemal Kanxha	109	3630	150	124					3	1700	23700	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
8	Fadi Muçina	69	3630	150	124			2	4500			32100	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
Totali					3 018							494 112	

Përfitimet
Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merret ose do të merret personi që vdes. Në rastet kur jetimi humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre



Pensionet familjare si do llogariten me ndryshimet në ligj

Përcaktohen përfituesit dhe masa e pagesës për çdo kategori, pas vdekjes së pensionistit

SONILA ISAKU
TIRANË

Kritere të reja do të zbatohen për përfitimin e pensionit familjar duke filluar nga 1 janari i 2015 në vendin tonë. Me hyrjen në fuqi të ligjit për "Sigurimet Shoqërore" paraqiten një sërë ndryshimesh të cilat kanë të bëjnë me ndryshime të moshës së familjarëve përfitues, ndryshim të masës së përfitimit të pagesës për personat që kanë në ngarkim. Sipas përcaktimeve të bëra, mosha e përfitimeve të pensioneve familjare për femrat është rritur, dhe po kështu kanë ndryshuar edhe kriteret e llogaritjes së pensionit.

LLOGARITJA

Pensioni familjar, përfitohet në ato raste kur një person i siguruar apo përfitues i pagesës humb jetën. Por, familjarët e tij nuk përfitojnë të njëjtën pagesë sa i takonte të ndjerit paor ai llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit. Kështu, pensioni familjar jepet në masën 50 për qind për personin e ve dhe 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë. Kur nuk merret pensioni i parashikuar, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtarë në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 për qind. "Shuma e një pensioni

Pagesat për vdekje
Përfitimi sa 50% e pagës minimale

— Pagesa për vdekje i jepet kur një personi të siguruar ose një pensionist në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes që ai e ka në ngarkim, si dhe në rastet kur personi u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi. Ndërkohë që me ligjin e vjetër kjo pagesë ka qenë e barabartë me një muaj pension bazë pleqërie.

familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merret ose do të merret personi që vdes. Jetimi ka të drejtën e një pensioni familjar edhe në qoftë se prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht

aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 për qind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 për qind e tij"

thuhet në ndryshimet ligjore. Kurse në rastet kur jetimi humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

KATEGORITË PËR FITUESË

Kur një person i cili është përfitues pensioni, humb jetën ligji i jep të drejtën familjarëve që i ndierit i kishte në ngarkim të përfitojnë pension familjar. Ndryshimet ligjore të bëra së fundmi përcaktojnë se kjo e drejtë i jepet së vesë e cila është e paaftë për punë dhe është mbajtëse e një fëmijë deri në 8 vjeç, fëmijë që ishte në ngarkim të të ndjerit. Por nëse me ligjin e vjetër kjo e drejtë i jepej gruas në moshën 50 vjeçare, me ndryshimet e reja ligjore mosha rritet në 55 vjeç. Kjo e drejtë përfitimi pensioni i jepet edhe burrit të ve, kur plotëson të njëjtat

kushte si gratë, por mosha e tij të jetë 60 vjeç. "Një tjetër kategori që do të trajtohen me pensionet familjare janë edhe jetimët. Jetimi përfiton nga skema e pensioneve familjare kur provohet se ai ishte në ngarkim të atij që vdiq dhe ka një moshë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studion ose është i paaftë për punë, para së të arrijë moshat e mësipërme" përcaktojnë ndryshimet ligjore. Pensionet familjare do të shkojnë edhe për prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë.

Ndryshimet që vijnë mbi pensionet familjare

- Pensioni familjar, përfitohet në ato raste kur një person i siguruar apo përfitues i pagesës humb jetën. Por, familjarët e tij nuk përfitojnë të njëjtën pagesë sa i takonte të ndjerit paor ai llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit
- Me ligjin e ri, mosha e përfitimeve të pensioneve familjare për femrat është rritur, dhe po kështu kanë ndryshuar edhe kriteret e llogaritjes së pensionit.
- Pensioni familjar jepet në masën 50 për qind për personin e ve dhe 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë. Kur nuk merret pensioni i parashikuar, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension
- Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merret ose do të merret personi që vdes
- Pensioni familjar i jepet të vesë e cila është e paaftë për punë dhe është mbajtëse e një fëmijë deri në 8 vjeç, fëmijë që ishte në ngarkim të të ndjerit. Por nëse me ligjin e vjetër kjo e drejtë i jepej gruas në moshën 50 vjeçare, me ndryshimet e reja ligjore mosha rritet në 55 vjeç
- Kjo e drejtë përfitimi pensioni i jepet edhe burrit të ve, kur plotëson të njëjtat kushte si gratë, por mosha e tij të jetë 60 vjeç

LAJME shkurt

Veliaj në Austri negociatat për pensionet

— Ministri i Mirëqenies Sociale, Erion Veliaj ka nisur negociatat me Austrinë sa i përket njohjes së pensioneve, por njëllojësisht ka treguar mundësitë që ofron Shqipëria në turizëm. Këto bisedime Veliaj i ka kryer me Presidentin e Unionit të Pensionistëve të Austrisë, Karl Blecha. Këtë të fundit, Veliaj i paraqiti idetë e bashkëpunimit dhe mundësitë konkrete që Shqipëria ofron për zhvillimin e turizmit së moshës së tretë në vendin tonë, sidomos pas mbylljes së sezonit turistik veror, me qëllim rritjen e punësimit. Për të pasur punësim të qëndrueshëm edhe pas verës, duhet të zgjasim sezonin turistik. Turizmi i moshës tretë pas sezonit veror e bën më të qëndrueshëm punësimin në hoteleri, punë sociale dhe infermierit", u shpreh ministri Veliaj pas nënshkrimit të marrëveshjes mes "Business Albania" dhe Unionit të Pensionistëve Austrisë për paketat e pensionimit në Shqipëri.



Tiranë, qendër e re për dhurimin e gjakut

— Në Ditën Botërore të Ndhimës së Shpejtë, në Tiranë është hapur një qendër e dhurimit vullnetar të gjakut. Ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqaj bën apel për dhurim vullnetar, për të shpëtuar jetën e dikujt në nevojë. "Shpesh herë, në rastet e emergjencave lind nevoja për gjak. Sigurisht që nuk duhet të kujtohemi kur kjo ndodh, por duhet të zhvillojmë një kulturë ku ditë pas dite të mund të ndajmë një pjesë nga jeta jonë edhe me të tjerët, që t'i gjendim pranë të tjerëve në ditë të vështira. Një qendër e tillë në mes të Tiranës është një vlerë e shtuar, pasi kemi mundësi të vendosim kontaktet me dhuruesit dhe t'i nxisim sa më shumë ata", tha Beqaj. Kjo qendër është mundësuar falë bashkëpunimit me një shoqatë italiane. Ministri Beqaj tha se në bashkëpunim me kooperacionin italian po mundësohet dhe investimi prej 5 milionë eurosh për spitalin e traumës.

Nis lyerja e shtyllave

Bashkia "ndërtuesi" te "Nënë Tereza"

— Punimet për rehabilitimin e sheshit "Nënë Tereza" në kryeqytet kanë sjellë "përplasje" mes qeverisë e Bashkisë së Tiranës, së cili prej tyre ndërmori nisëm për t'i dhënë një pamje të re sheshit. E ndërsa nga të dyja palët ka pasur deklaratat, reagime, si dhe publikime të fotove sesi do të jetë ky shesh pas rehabilitimit, duket se Bashkia e Tiranës ka vendosur të lërë një "shenjë". Kështu, përpara Fakultetit Politeknik, Bashkia e Tiranës ka vendosur

tabelën e punimeve, ku thuhet se këto punime "Rivitalizimi i sheshit Nënë Tereza" po realizohen nga ky institucion, duke bërë kështu në një farë mënyrë "përvetësim" të punimeve. Në tabelë shënohet se punimet parashikohen të zgjasin një muaj, dhe kapin një vlerë prej 75 milionë lekë. Ndërkohë vetëm një ditë pas publikimit të një fotoje të kryeministrit ku tregoheshin shtyllat e palera, bashkia dje ka nisur t'i bojatisë ato gjatë ditës së djeshme.





Greqi, një burrë e një grua u dënuan nga gjykata e Selanikut Kërcënuan familjen shqiptare, një vit burg neonazistëve

— Dy anëtarët të partisë neonaziste Agimi i Artë janë dënua nga Gjykata e Selanikut me 12 muaj burg. Vendimi është marrë pas denoncimit për kërcënime me vdekje që ata të dy kanë bërë ndaj një familje shqiptare. Vendimi është dhënë të premten, pasi disa seancash. Ngjarja për të cilën u dënua dy anëtarët e Agimit të Artë, ka ndodhur në nëntor të vitit 2012 kur një burrë dhe një grua greke, anëtarë

të partisë neonaziste Agimi i Artë kanë kërcënuar me vdekje familjen shqiptare. Hetimi i çështjes filloi, pas një ankese të bërë nga familja shqiptare. Sipas gruas shqiptare që kallëzoi dy anëtarët e Agimit të Artë, ata e kishin kërcënuar se do t'i digjinin shtëpinë nëse nuk largoheshin së bashku me burrin dhe dy fëmijët e mitur nga Greqia. Të njëjtat kërcënime janë përsëritur disa ditë

më vonë, këtë herë dy të arrestuarit (një burrë dhe grua, anëtarë të Agimit të Artë) kanë kërcënuar në telefon kryefamiljarin shqiptar. Pas kësaj, policia kishte nisur hetimin e saj dhe në fund kishte arritur të siguronte provat e duhura kundër dy anëtarëve të partisë ekstremiste greke. Pas disa seancash, gjykata e Selanikut ka vendosur dhe dënimin e tyre me nga 1 vit burg.

Aksioni

INUK prish ndërtime pa leje në Tiranë e rrethe



■ Prej disa ditësh INUK ka ndërmarrë aksione në Tiranë dhe në rrethe për lirim dhe hapësirave publike, e kthimin e tyre tek qytetarët, dhe heqjen e tabelave reklamuese vendosur në mënyrë të kundërligjshme në të gjitha aksent rugore. Veprimet e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar nisën dy javë më parë me heqjen e tabelave të paligjshme të reklamave vendosur në të dy krahët e rrugëve kryesore. Në këtë aksion që vazhdon ende janë angazhuar sektorët e INUK në Tiranë dhe qarqe. Me gjithë angazhimin e efektivave në projektet me rëndësi kombëtare në Tiranë, si zgjerimi i rrugës së Elbasanit, lirim i hapësirave për realizimin e punimeve në "Unazën e Madhe" apo dhe Sheshin "Nënë Tereza", INUK prej tre ditësh ka nisur superoperacionin për lirim dhe hapësirave publike në dy nga rrugët më problematike "Hoxha Tahsin" dhe "Muhamet Gjollështa". Në ditën e parë të operacionit, që filloi nga kryqëzimi i rrugës "Hoxha Tahsin" me rrugën "Bardhy" e deri tek Sheshi "Shtraus", njohur ndryshe edhe si "Xhamlliku", u prishën 31 objekte të kundërligjshme, kryesisht shtesa pallatesh përshtatur për biznes apo tenda stacionare me konstruksion të lehtë dhe metalik, që kishin zënë hapësirat publike. Prej kohësh INUK kishte sensibilizuar zotëruarit e tyre, ndaj dhe ata morën masa për heqjen ose prishjen e tyre. Mjetet e rëndta të INUK ndërhyn vetëm në ato objekte ku poseduesit e kishin të pamundur prishjen e tyre. Në ditën e dytë të operacionit po në këtë rrugë u prishën 29 objekte pa leje nga Shehi "Shtraus" deri te kryqëzimi i rrugëve "Kujtim Laro" dhe "Xhafize Keko". Në ditën e tretë janë prishur po 25 objekte pa leje, ndërsa ka filluar largimi i materialeve dhe çmontimi i tregut të fruta-perimeve që ishte kthyer në një problem serioz për banorët e kësaj zone, pasi ishte vendosur në mes të kryqëzimit të rrugëve jashtë standardeve dhe normave higjieno-sanitare.

Hyn të qetësoje sherrin, i riu goditet me thikë për vdekje

Adoleshenti Ardit Koka vritet në mes të qytetit të Rrëshenit

ARTAN CENA
RRËSHEN

H yn të shuajë sherrin, por goditet me thikë në zemër duke humbur jetën. Këtë fat tragjik ka pasur 18-vjeçari Ardit Koka, mbrëmjen e të premtes në mes të qytetit të Rrëshenit, në momentin kur dy grupe të rinjsh të cilët më parë ishin zënë në lokal. Sipas policisë, adoleshenti Koka ishte i njohur pasi ishte një kontigjent kriminal dhe rreth 3 javë më parë ishte shoqëruar në polici, pasi kishte kërcënuar për vrasje familjen e tij, pasi nuk i jepte para për të blerë drogë.

VRASJA NË QYTET

Një i ri nga Rrësheni ka ndërhyrë për të mbrojtur shokët teksa po ziheshin me një grup tjetër, por ka humbur jetën. Mbrëmjen e të premtes, në këtë qytet, 18-vjeçari, Ardit Koka është qëlluar me thikë në zemër nga Alban Molla 26 vjeç. Ngjarja ka ndodhur në ambientet e një lokali, ku dy grupe të rinjsh kanë nisur të zihen për motive banale. Ndërsa ka parë shokët e tij të ndeshen, adoleshenti ka ndërhyrë në mbrojtje të tyre. Por, vetëm pak minuta më vonë kur sherrri kishte përfunduar 26-vjeçari, Alban Molla e ka prituar atë jashtë lokalit dhe sapo Arditi është afruar e ka qëlluar me armën e ftohtë duke i shkakuar vdekjen. Autori i krimit ka mundur të largohet por, pak orë më vonë është arrestuar nga policia. Ai ka pranuar autorësinë e krimit.

PRECEDENTI

Pas kërcënimit të familjes, Koka ishte vënë në pranga nga policia por më pas është lënë i lirë, duke humbur jetën 2 ditë më parë

SHERRI NË LOKAL

Ngjarja ndodhi pranë lokalit "Everest" në bulevardin e qytetit të Rrëshenit. Burimet e policisë së Mirëditës thanë se i riu Koka ka ndërhyrë pasi ka parë shokët e tij duke u zënë me një grup të rinjsh, ndërsa arsyeja e sherrit ishte për mënyrën e shikimit. 18-vjeçari ka ndërhyrë duke goditur me grushte 26-vjeçarin Molla dhe një tjetër shoqëruar të tij. Pas sherrit i riu 18 vjeçar është futur sërisht në lokal dhe ka qëndruar për pak kohë. Vetëm pak minuta më vonë Ardit Koka ka dalë nga lokali, ndërsa jashtë e priste grupi i të rinjve kundërshtarë. Sapo ka dalë në trotuarin pranë lokalit, 18-vjeçari i është afruar Alban Molla dhe e ka qëlluar menjëherë me thikë, goditje e cila ka rezultuar fatale për të riu.



Ardit Koka

VIDEO/VRITET NË MES TE QYTETIT I RIU

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

Kërcënimi

Mesditën e 16 gushtit të këtij viti, Ardit Koka kishte kërcënuar me një thikë familjen e tij, që nëse nuk do ti jepnin lekë për të blerë drogë atëherë ai do ti vriste ata.

Aksioni në Pogradec

Humbja e jetëve, nis mbyllja e galerive të braktisura

— Galeritë e braktisura në rrethin e Pogradecit janë mbyllur. Edhe pse për vite me radhë në këto galeri minierash të braktisura banorët e Beragoshdës hynin për të mbledhur skrap, pa u kujdesur për jetën e tyre, Ministria e Energjitikës ka vendosur që ti mbyllë për të kursyer jetë njerëz. Galeri

të cilat vetëm pak kohë më parë kanë marrë jetën e pesë të rinjve të këtij fshati të cilët kishin hyrë aty për të gjetur hekura për t'i shitur më vonë për skrap. Por, pas këtyre aksidenteve në të 14 galeritë në këtë fshat ka nisur puna për izolimin e tyre brenda parametrave të kërkuara, me qëllim sigurinë e jetës së


njerëzve. Ndonëse varfëria i ka shtyrë këta banorë t'i shfrytëzojnë këto galeri të rrezikshme ata janë të bindur se ato duhen mbyllur. Në rrethin e Pogradecit ka të tjera galeri minierash të hapura, përfshi këtu edhe ato të Verdovës, të cilat për rrezikshmërinë që paraqesin për banorët duhet të mbyllën.

Karriera

Ish-futbollisti Skerdi Bejzade, 39 vjeç, ka lindur në Elbasan. Ai ka pasur një karrierë të pasur duke u aktivizuar me shumë skuadra si Vllaznia, Partizani, Dinamo, Elbasani etj.

Banesa

Dyshohet se lënda shpërthyesë ka qenë produkt i një bombe artizanale. Banesa e ish-futbollistit Bejzade, është shtëpi përdhese në zonë e rrugës së Dibrës në Tiranë.



Banesa ku ndodhi shpërthimi

VIDEO/ TRITOL SHTËPISË SË ISH-FUTBOLLISTIT

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shikkohet falas

LAJME shkurt



E përplas makina, në gjendje të rëndë e moshuara

— Një grua e moshuar ka marrë plagë të rënda nga një aksident rrugor. Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në Tiranë, kur një fuoristradë ka goditur një grua. Nga ngjarja për pasojë ka mbetur e plagosur një e moshuar. Mësohet se automjeti tip fuoristradë e ka përplasur gruan në rrugë në momentin që ajo ka qenë duke kaluar nga njëri krah në tjetrin. Pas plagëve të marra, bëhet me dije se e moshuara është transportuar në gjendje të rëndë për në spital. Identiteti i të plagosurës dhe drejtuesit të mjetit nuk janë bërë të ditur nga policia. Ndërkaq, burime nga bluzat e bardha të Spitalit të Traumës në Tiranë kanë bërë të ditur se, e aksidentuara është në gjendje të rëndë. Sakaq, policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.



Vidhin bagëti në Përmet, arrestohen 3 fierakë

— Prej disa kohësh vidhnin bagëti në zonën e Përmetit, por vetëm mëngjesin e djeshëm, Policia e Gjirokastrës ka bërë të mundur arrestimin e të dyshurave. Janë 3 persona nga rrethi i Fierit të cilët janë vënë në pranga, pasi akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin vidhnin bagëti në fshatra të ndryshëm të zonës së Përmetit. Në pranga e policisë janë vënë tre personat me inicialet Ç. Mesutaj, K. Likaj dhe Z. Muskaj, të gjithë nga Fieri. Sipas policisë, njëra prej vjedhjeve e cila është faktura me prova ka ndodhur para 6 muajsh, në Komunën Sukë të Përmetit, por është duke u hetuar edhe për përfshirjen e tyre në disa ngjarje të ndodhura kohë e fundit në këtë zonë. Bëhet me dije se këta persona, kanë vjedhur 3 lopë në banesën e një personi.

Eksplziv banesës së Skerdi Bejzades, dyshime për borxhe

Shpërthimi në mesnatë. Ish-futbollisti jeton në Gjermani

ARTAN GENA
TIRANË

paralajmërim për ish-futbollistin.

SHPËRTHIMI NË BANESË

Një shpërthim i fuqishëm tritoloi ndodhi në orët e para të mëngjesit të ditës së djeshme në rrugën "Ibrahim Kazazi" në Tiranë. Sipas informacioneve të policisë, shpërthimi ka ndodhur në banesën e ish-futbollistit Skerdi Bejzade. Në momentin e shpërthimit në banesë ndodhej vetëm e ëma e ish-futbollistit. Dyshohet se lënda shpërthyesë ka qenë produkt i një bombe artizanale. Banesa e ish-futbollistit Bejzade, është shtëpi përdhese, ndërsa dyshohet që lënda eksplozive të jetë vendosur në te porta e oborrit në hyrje të saj. Si pasojë e shpërthimit ka pasur vetëm dëme materiale. Grupi hetimor, i mbërritur në vendngjarje nisi punën për të zbardhur dokumentimin e plotë të ngjarjes.

PISTAT E HETIMIT

Dy janë pistat kryesore sipas ek-



Pasi la karrierën si futbollist, Bejzade ka qenë edhe trajner i skuadrës së Partizanit dhe Kamzës, por duke mos lënë ndonjë shenjë në fushën e trainigut.

spertëve, njëra lidhet me konfliktet e pronësisë, ndërsa pista e dytë mund të jetë edhe humbia e një sasie parash në bastet sportive. Pritet ardhja e ish futbollistit nga Gjermania për të sqaruar rrethat e ngjarjes. Nga të dhënat e grumbulluara mësohet se, familja e Bejzades prej vitesh jetonte në Gjermani, ndërsa ai shkoi dhe vinte. Por kohët e fundit duket se, ai ka shkuar duke mos u kthyer më në Tiranë.

KUSH ËSHTË BEJZADE

Ish-futbollisti Skerdi Bejzade, 39 vjeç ka lindur në Elbasan. Ai ka pasur një karrierë të pasur në Kampionatin shqiptar duke u aktivizuar me shumë skuadra si Vllaznia, Partizani, Dinamo ku ka nisur karrierën dhe me Elbasanin, me të cilin ka dalë edhe kampion. Pasi la karrierën si futbollist, Bejzade ka qenë edhe trajner i skuadrës së Partizanit dhe Kamzës, por duke mos lënë ndonjë shenjë në fushën e trainigut.

Mallra kontrabandë nga Greqia pranga tregtarit e dy doganierëve

Të arrestuarit: Dritan Islamaj, Redi Karalli e Ndrichim Stojku

Arrestimi SARANDË

Futja e mallrave ushqimore kontrabandë nga Greqia, ka bërë që dy doganierë të Pikës së Kalimit Kufitar të Kakavijës, të vihen në pranga. Aksioni i arrestimit të Redi Karallit, 32 vjeç banues në Gjirokastrë dhe Ndrichim Stojkut, 32 vjeç banues në Tiranë është bërë mëngjesin e djeshëm nga efektivi e Policisë së Sarandës. Bashkë me ta është arrestuar edhe Dritan Islamaj, 42 vjeç, tregtari i cili tregtonë mallin e kontrabanduar, kundrejt pagesave të parave që ua jepte dy doganierëve. Gjatë ditës së djeshme, policia ka bërë të ditur se, arrestimet janë kryer gjatë operacionit të koduar "Vjeshtë 2014". Sipas policisë, doganierët e



Kakavijës, veprën penale nuk e kanë kryer në vendin e tyre të punës por ata kishin shoqëruar tregtarin në Pikën e Kalimit Kufitar të Qafë Muzinës në Sarandë. "Arrestimi i këtyre personave është kryer pasi ditën e sotme (dje) shtetasi

Hetimi

Mallrat ushqimore si dhe një sasi kafeje që janë bllokuar, do të tregtoheshin në qytetin e Sarandës. Policia po kryen hetime në lidhje me këtë rast.

Dritan Islamaj, është kapur nga shërbimet e policisë në "Qafën e Muzinës" duke transportuar me automjetin e tij të tipit Mercedes-Benz me targa AA 754 AZ, një sasi mallrash ushqimore dhe kafe me vlerë disa mijëra euro, për të cilat ky shtetas nuk kishte paguar detyrimet doganore", ka bërë të ditur zyrtarisht dje Policia e Vlorës. Pas ndalimit të tij, janë ndaluar edhe dy doganierët që kishin ndihmuar tregtarin. Mallrat ushqimore si dhe një sasi kafeje që janë bllokuar, do të tregtoheshin në qytetin e Sarandës. Policia është duke kryer ende hetime në lidhje me këtë rast kontrabande.

Raporte elitare vs raporte militante mes shqiptarëve

NGA **AFRIM KRASNIQI**

Sa herë afrohen fushatat elektorale apo festat kombëtare thirrjet populiste për "bashkim kombëtar" dhe projekte të shpejta nacionaliste na japin idenë e gabuar se shoqëritë shqiptare, ajo në Shqipëri dhe në Kosovë, janë të gatshme të marrin përgjegjësitë e një ndryshimi cilësor dhe historik. Në ligjërimin politik thihren në skenë emrat më të njohur të periudhës së Rilindjes Kombëtare apo Periudhës së Pavarësisë dhe kështu, krijohet ideja se elitat gjithnjë e kanë dashur bashkimin, jo si proces mekanik, por si proces mendimi dhe veprimi qytetar dhe evropian. E njëjta përsëritet edhe në ligjërimin politik të elitave të tranzicionit në dy vendet. Secila flet për shkrirje shpirtërore, secila sugjeron mjetet e ndryshimit dhe ofron këshilla ndaj gabimeve të tjetrit, dhe kështu, krijohet ideja e gabuar e një procesi komplementar, elitat, institucional dhe konsensus.

Në praktikë bilanci është krejt tjetër. Le të marrim në konsideratë një aspekt thelbësor: sjelljen mediatiqe dhe raportin që ajo na krijon me publikun e vendeve tona. Për arsye studimore kam mbajtur shënim të gjithë titujt e mediave të Tiranës lidhur me zhvillimet në Kosovë dhe anasjelltas, titujt e mediave të Prishtinës ndaj zhvillimeve në Shqipëri. Përfundimi është shokues: palët operojnë me mjetet e tjetrit, me lajmin e tjetrit pa e verifikuar dhe vlerësuar atë, dhe kështu, gjuha degraduese e debatit ditor përcillet në Prishtinë, dhe anasjelltas. Batutat fyre apo akuzat banale midis politikanëve të Tiranës, qofshin ato në replikat parlamentare apo në shënimet në rrjetet sociale zënë vend në të gjitha faqet online të mediave të Kosovës, me të njëjtin titull, me të njëjten gjuhë, pa redaktim, etikë, verifikim dhe selektim. Rama "tradhtar apo hajdut", Basha "kryebashkiak koti apo hajdut", deri edhe Kaci "i zi: apo detajet fyese të dasmës së ministrit i jepen publikut të Kosovës live, si lajm i fundit, si "lajme nga Shqipëria" dhe kështu përmes tyre në Kosovë prezantohet politika, shoqëria dhe shteti i Shqipërisë. E anasjelltë, batutat mes Ramushit e Hashimit, Albinit dhe Isës, replikat e tyre në rrjetet sociale apo akuzat e konsumit politik, ofrohen në Tiranë si "lajme nga Kosova", duke krijuar një imazh të rremë, negativ, dhe denigrues për jetën institucionale, politiken, shoqërinë dhe shtetin e Kosovës. I njëjti proces shkon edhe më tej, në lajmet rozë mbi veset, tradhtitë, zhveshjen, ndërjet apo skenat që improvizojnë personat publikë, këngëtarë apo sportistë nga dy vendet. Askush në Tiranë nuk është në dijeni p.sh. për programin teator të Prishtinës dhe anasjelltas, por të gjithë kanë dëgjuar për batutat mes ca vajzave të zhveshura që quhen këngëtarë dhe që diskutojnë mbi këmbët e tyre.

Në aspektin teknik raporti midis mediave në Tiranë dhe në Prishtinë i ngjason raportit midis mediave të Tiranës dhe çdo vendi tjetër në botë, dhe anasjelltas. Asnjë gazetë e Tiranës nuk shkon në Prishtinë dhe anasjelltas. Asnjë studio televizive nuk ka zyrë të plotë pune në Prishtinë dhe anasjelltas. Asnjë program mediatiq bashkëpunimi nuk është krijuar midis dy kryeqyteteve, asnjë pedagog gazetarie nuk ftohet në Tiranë dhe anasjelltas. Nga Tirana ndodh të ftohen në Prishtinë për të folur mbi politikën komentues që financohen nga një kompani me interesa ekonomike në dy vendet, dhe anasjelltas, secili me skenar të përgatitur më parë dhe në funksion të pushtetarit të radhës. Nuk ndodh që kritika dhe vëzhgimi profesional të arrijë të bëjë dallimin dhe të tejkalojë kufijtë për tu dëgjuar dhe respektuar, të paktën formalisht, siç nuk ndodh që politikanët e Tiranës të kenë autoritet, vullnet apo bindje të ndikojnë me këshilla pozitive tek homologët në Prishtinë dhe anasjelltas. Kriza e fundit politike në Kosovë e tregon më së miri këtë. Asnjë nismë nga Tirana, asnjë këshillë, asnjë shqetësim, asnjë lajm as në takimet e shumta midis liderëve tanë. Dhe anasjelltas. Nëse i besojmë reklamës, sidomos asaj që sjell fitime, gjithnjë gjendet një personazh publik në Tiranë dhe Prishtinë që thotë se produkti i tyre po bën bashkim kombëtar, ngaqë shteti në dy anët e kufirit! Por nëse shohim debatin publik, duke pasur parasysh se problematikat e dy vendeve thuajse janë të njëjta, përveç një replike të nisur elitare dhe për përfunduar me gjuhë populiste midis Kadareës e Qosjes, nuk ka pasur më asnjëherë përfshirje thelbësore të elitave publike të dy vendeve. Më shumë se nxitje debati dhe tërheqje opinioni, zërat e Kosovës ftohen në Shqipëri vetëm për të përforcuar opinionin e atyre që i ftojnë, pra për ti dhënë debatit ditor përmbajtjen e një mbështetje "kombëtare", dhe anasjelltas. Mjafton një detaj: gjuha fyese dhe refuzimi institucional që u përdor midis dy akademive tona të shkencave, të cilat prej kohësh nuk komunikojnë dhe nuk bashkëpunojnë. Natyrisht, për arsye tërësisht jo shkencore, por thellësisht provinciale.

Së fundi, një vlerësim kritik meriton edhe produkti tjetër, ai i librit dhe dijes. Në Tiranë rinia universitare mund të zgjedhë midis 2-3 mijë titujve akademikë, shumica produkte përkthimi, por gjithsesi, tekste të shtypura. Sa prej tyre janë autorë nga Kosova? Sa gishtat e njërës dorë. Në Prishtinë studentët mund të zgjedhin gjithashtu midis mijëra titujsh, edhe aty, shumica produkte përkthimi. Sa autorë janë nga Shqipëri? Sa gishtat e dorës tjetër. Vërtetë në kemi kaq shumë produkte, kaq shumë autorë, kaq shumë shkencëtar, dhe njëherësh jemi kaq të ndryshëm në perceptimin e shkencës, sa preferojmë të dublojmë librat, shkencën, përkthimet, pa marrë parasysh koston, dhe

dëmit që i shkaktohet sistemit të vlerave, hierarkisë shkencore dhe vetë dijes për brezin e ri? Një student amerikan studioi sot çdo libër profesional në qarkullim, pavarësisht nëse është autor gjerman, francez apo britanik. Dhe anasjelltas. Po në botën shqiptare kaq e vështirë është që minimalisht të lexojmë njëri tjetrin? Sa projekte universitare kemi sot midis dy vendeve? Sa shkëmbime shkencore dhe aplikime për projekte rajonale? Me siguri, më pak sesa gishtat e njërës dorë. Politika lart thotë se gjërat janë në vijë, kur i shikon problemet në rrafshin praktik vija ngjan më shumë si labirint.

Politika në Tiranë ka kohë që flet për Rilindje. Në Kosovë të gjithë e duan Rilindjen, natyrisht atë që njohim të gjithë, të vjetrën, atë që sakrifikoi dhe pati vizionin të krijonte bazën për shtetin, shoqërinë dhe identitetin shqiptar. Jashtë sloganeve dhe premtimeve populiste, a nuk është koha që nga premtimet e mëdha të kalohet tek gjërat e vogla, të përditshme, tek ndryshimet e prekshme, të dukshme dhe më të nevojshme? A nuk mund mundet edhe mediatiq të heqin dorë nga eksportimi live i të keqes, për t'u rikthyer misionit informues dhe profesional? A nuk mundemi të pajtojmë akademikët tanë që të takohen e flasin, të bashkëpunojnë dhe të marrin përgjegjësitë e shkencës? A nuk mund të krijojmë raporte institucionale me vendimmarrjen politike në Kosovë dhe anasjelltas, duke hequr dorë nga praktika klienteliste e shpikjes dhe marrjes në avion apo post të një miku personal nga Prishtina/Tirana në krah si alibi për të thënë se kam Kosovën/Shqipërinë në krah? A nuk mund të mesohemi të respektojmë atë që respekton vetë qytetaria e Tiranës/Prishtinës duke hequr dorë nga mitet dhe dashuritë e përjetshme apriori mbi figurat politike, të cilat projektet e mëdha idealiste i përdorin për të vetmin qëllim, forcimin dhe jetëgjatësinë me çdo kusht të pushtetit personal? A nuk duhet të jemi të gjithë më shumë kritik e të vëmendshëm ndaj sistemit të partitokracisë, pashallëqeve partiake, firmave fitimprurëse partiake, që kanë zënë hapësirën, debatin, si dhe kanë kapur shtetin, administratën, sistemin e drejtësisë dhe po krijojnë oligarkitë të re në Tiranë e Prishtinë?

Në rrethin vicioz jo shoqëritë tona janë futur përmes politikës së keqe, imponimit të oligarkisë, raporteve klienteliste dhe përdorimit të medias si ushqim konflikti, shoqëritë tona po funksionojnë si shoqëri që prodhojnë militantë, jo qytetarë aktivë, të lirë dhe me integritet. Përballë këtij realiteti pyetja dhe sfida themelore mbetet: a nuk kemi nevojë të gjithë të punojmë për një shoqëri më aktive, më të hapur, më komunikuese, më konkurruese, më pak folkloriste, më pak egoiste dhe shumë më tepër qytetare? Diçka që të afro, dhe që të krijon ndjesinë e bashkimit rreth vlerave dhe të mirës.

Blog/ Grimca Urbane

A ishim më mirë kur ishim më keq?

NGA **EVIS CERGA**

Kur zbrisnim me zhurmë, me shapka dhe sandale të njësojta shkallë të pallateve katërkatëshe të njësojta dhe mbanim në duar bukë me gjera të njësojta. Dikush me vaj me sheqer, dikush me gjalpë e domate, dikush me djathë, dikush me sheqer e me ujë. Por zbrisnim ama. Zbrisnim dhe luanim nëpër rrugët e zbrazëta ku kalonin dhe takonin bicikleta komshinsh që ngacmonin ndonjë komshije tjetër, më të rritur se ne sigurisht. A ishim më mirë? Sigurisht atëherë ne e nuk dinim, dhe as nuk dinim, por as na shkonte mendja të dinim përtej botës së vogël të lagjeve dhe shkollave tona. Lagjet dhe shkollat tona ishin gjithë bota jonë, përtej orëve të shkurtra të televizionit bardhë e zi, ku emisioni më i preferuar mbetet "Rreth tryezës së redaksisë". Kjo ishte ironike...Asnjëherë nuk e kam parë atë emision deri në fund sepse nuk e kuptoja. Tryezën e kuptoja, redaksinë jo.

Por le të mbetem tek lagjia ime, me banorët e saj të njëtrajtshëm. Me gratë me buzëkuqe të blera në kinkalerinë e lagjes, që me gjasë mund të përhapen shpejt e të ngjitet në letren e ambalazhit, të cilat më dukeshin të bukura. Me funde e fustane të blera në MAPO-në e lagjes, jo kërkoj ndjesë, me copën e blerë aty dhe qepur tek Burbuqja, Thëllënxa e shoqe të tyre. Të gjitha dukeshin aq njësoj saqë Estrada nisi të verë në skenë edhe skece mbi këtë temë.

Atëherë nuk kishte "pub"-e. Në kishim klubin e lagjes, por kishim edhe Klubin e Përqeve, ky I fundit, nuk e di pse më ka intriguar vazhdimisht. Me pëlqenin pleqtë kur luani tavill, ndonëse dembelizmi nuk më ka pëlqyer kurrë. Në klubin e lagjes më kujtohen disa ëmbëlsira që më tërhiqnin në vecanti: hashurja, hallva dhe pasta shutat (ekleri). Një moment shumë interesant mbetet mbërritja e xhaxhës së akulloreve dhe mbërritja e kallupit të akullit tek klubi në qoshk. Eh, ç'gëzime idiotese.

Oh, interesante ishte aroma e gomës kineze, madje edhe e rrëshirës që përdornim për të bërë "manicyr".

Interesante ishin kallamaret e bojës që na derdeshin në cantë dhe mund të nxinin dhe "drurin". Nuk ishin interesantë disa mësuës që nuk vlejnë të quhen të tillë. Ishin shumë mbresëlënëse mësuës e edukatorë të tërë që na shtynë, "si dele" në shkolla e auditore. Dhe ne ndoqëm rrjedhën e jetës, ashtu si dinim, ashtu si mendim. Pa shampo të shtrenjta e të lira, pa parfume, me Kolonja të kinkalerive, pa shumë fustane, por me fustanin me topa, që vishnim për ditë lindjen e shoqëve dhe shokëve...githmonë atë fustan. Pa "pub" e, por me shumë muzikë, pa shumë libra, por plot me dije, pa shumë gjera, por me dashuri. Ndërsa sot...sot e dimë vetë të gjithë se ku qëndrojmë. Ka njerëz nostalgjikë. Sigurisht, bota është e mbushur plot me të tillë. Unë jam një ndër ta...

RILINDASI

Viti IV - Nr:37

E diel, 14 shtator 2014

Kryeredaktore: Admirina PEÇI



SENDET PERSONALE TE GURAKUQIT

Reliket që Gjon Kamsi solli nga Bari sot në mëshirë të fatit

NGA PJETER LOGORECI

Si fëmijë e si nxënës, rrugës për në shkollë, u përshkova vjet me rradhë para shtëpisë së Luigj Gurakuqit, ku shpesh ndalesha te dera e prej ndonjë plase në drunin e vjetër, kuriozohesha tuj pa grykën e rrasën e pusit, shkallët me gurë të latuem e madhështinë e çardakut karakteristik. Duke qenë se fantazia e fëmijës shkon shumë larg, përshkoja me imagjinatën time dhomat e errëta e të pluhrosuna të kësaj shtëpie, drejt xhamave ku gjendeshin teshat e gjakosuna e me gjurmë plumbash të Luigj Gurakuqit, burrit që e deshti deri në flujim atdheun.

Por duhet thanë qi pata fat, mbasi brezat e sotëm munden vetëm me ndigjue për shtëpinë (e asgjesueme) muze, se një ditë mësuesi im i historise (zotni Mark Temali) na dha shansin me e vizitue muzeun, me i pa këto relike e me kuptue se çfarë bën dora tradhtarë e atij që shet nderin dhe



Dorezimi i rrobave nga patrioti Gjon Kamsi në Shtëpinë – Muze të Luigj Gurakuqit

kombin. Atë ditë, vizitën tonë na e zbkurruan dëshmitë e dhimbshme e të paharrueshme për vrasjen në pritë të Gurakuqit, që po na i tregonte një burrë i moshuem, i cili ishte dhuruesi i teshave të martirit Gurakuqi, kur shtëpia e tij u bë muze, akt të cilin qyteti i Shkodrës e përcolli me simpati dhe respekt. Ky burrë i moshuem ishte atdhetari shkoderan Gjon Kamsi, i cili ishte mik i ngushtë i Luigjit, të cilin e pat edhe kumbar në martesë.

Akti i ruajtjes dhe dorëzimit të objekteve, akt i rrallë patriotik

Ishte dita e 18 shkurtit 1964 kur Gjon Kamsi (sipas aktit të dorëzimit të mbajtur me këtë qëllim), një ditë para se të hapej Muzeu, u paraqit në dyert e shpise së Gurakuqve dhe i dorëzoi drejtorit të muzeut popullor në Shkoder, Vasil Llazari, 53 objektet që i përkisnin heroit tonë kombëtar Luigj Gurakuqi. Në mes të objekteve gjendeshin dhe një palë pantallona me njolla gjaku të cilit martiri i pati të veshura në momentin e vrasjes (atentatit)..

...vijon në faqen 15-17

Ndue Shyti, një libër odeon për bardin e madh të çiftelisë

Në 80-vjetorin e lindjes së "Artistit të Popullit" Ndue Shyti, "Nderi i Kombit". Mbi monografinë e sapo botuar të Mark Mesulit "Gjeniu i Çiftelisë"

NGA NDUE DEDAJ

Libri i Ndue Shytit ishte sa i shkruar (nga dhjetëra autorë, në një gjysmë shekulli, në aq e aq artikuj e gjer monografi të shkurtëra kushtuar artistit), aq i pashkruar, ndaj studiuës i përkushtuar Mark Mesuli, në librin e tij "Gjeniu i Çiftelisë", që sapo ka dalë nga botimi, ka meritën se e bëri "njësh" atë lëndë të bollshme që ishte e hallakatur në kronika, reportazhe, studime etj. Nga ana tjetër libri, është original jo vetëm nga prurja për herë të parë e mjaft materialeve të vjelura nga bisedat e gjata...

...faqe 22



Katedralja e Shkodrës e shndërruar në xhami

Arbëria-Shqipëria, si hapësirë e Krishtërimin

Një historik i gjurmëve të krishtërimin nga lindja e tij dhe përhapja në zonat ilirike, përballja me islamizimin, dhe sfidat e dy shekujve të fundit, nga dhunimi ekstrem në regjimin komunist deri në ringjalljen e besimit pas viteve '90...

DR. DOM NIKË UKGJINI

...faqe 20-21

Historishkrimi Diskutimet për Luftën, si u zhduk termi "luftë civile"

Qëndrimi i Byrosë Politike ishte i prerë "për sa i përket luftës nacionalçlirimtare të hiqen termat "lufta civile" dhe çështja nuk u diskutua më gjatë...

NGA DR. SONILA BOÇI

Ndërsa ndryshimi i historisë së Lëvizjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme u përdor për legjitimimin e pushtetit të komunistëve, shkrimi i historisë së Luftës së Dytë Botërore do t'u shërbente tri qëllimeve: diskreditimit të kundërshtarëve politikë; mitizimit të lëvizjes partizane dhe krijimit e kultit të individit për drejtuesit komunistë. Edhe diskutimet mbi historinë e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore ndoqën të njëjtën udhë si ato për ngjarje të tjera. Në ndryshim nga Lëvizja ...

...faqe 18-19



FOTO 11: Gjon Kamsi nderon kujtimin e viganit Luigj Gurakuqi



FOTO 1: Shtëpia muze ku lindi patriotit Luigj Gurakuqi në Shkoder



FOTO 6 GJON KAMSI NË MES TË NXËNËSVE NË MUZEUN E LUIGJ GURAKUQIT



FOTO 7: Martiri patriot Luigj Gurakuqi, firmëtar i pavarësisë, demokrati dhe luftari i papërkulur për lirin e atdheut




FOTO 4: Akti i dorëzimit faqe 2



FOTO 8: Gjon Kamsi me te shoqen Rozë Darrajati Kamsi



FOTO 10: Gjon Kamsi me familjen e tij

← binte vegëlë Ottavin-o e ma vonë luejti me Flaut. Punën e nisi si nëpunës në postën e qytetit e vazhdoi mandej si ekonomist e llogaritar në një shoqëri franceze. Në kohën e luftës së parë botnore u vendos si ekonomist në Drejtorinë e Përgjithshme të Financës së shtetit shqiptar. Së bashku me Luigj Gurakuqin e atdhetarë të tjerë, Gjoni mori pjesë në shumë aktivitete patriotike, e në vjetin 1918 bashkë me disa aktivistë shkodranë, arrestohet nga policia me akuzën se “po organizonin një kryengritje për futjen e Shkodrës nën influencën e qeverisë së Durrësit.”

Më vonë, për të vazhduar studimet e malta universitare, familja e dërgon Gjoni në universitetin e Barit në Itali në degën Ekonomi-Tregti, të cilën për shkak të fillimit të luftës së parë botnore ju desht ta ndërprejë. Me mbarimin e luftës Gjoni rikthehet në Bari ku diplomohet në po atë degë.

Gjatë lëvizjeve të shqiptarëve të Kosovës kundër Serbisë, Gjoni së bashku me Hasan Prishtinën organizojnë blerjen dhe dërgimin në Kosovë, të armëve dhe të 1 milion fishekëve për kryengritësit. Ndërkohe ai është prezent me botimet e tij si në shtypin vendas ashtu dhe në atë të huaj me shkrime mbi ekonominë e financën me pseudonimet: GJKAM, DR. VERITAS apo SCODRENSI. Kthehet në atdhe në vjetin 1940 dhe emërohet anëtar i këshillit kontrollues të llogarive të shtetit që kishte tagrin për të kontrolluar të gjitha dikasteret. Gjoni është i pari shqiptar, i cili ka botuar të plotë biografinë e heroit Luigj Gurakuqi,

e cila doli në Konstancë të Rumanisë në fletoren “Shqiperia e Re”. Më vonë arrin të mbledhë dhe të botojë në Bari të Italisë të gjitha poezitë e Luigj Gurakuqit në një vëllim të titulluar “Vjersha”. Mbas kthimit në atdhe ai martohet me Roza Darrajatin, të bijen e patriotit Pjeter Darrajati, me të cilën pat dy fëmijë.

Nuk mund të harrohet një leter e hapur me titullin “Mbi arsimin dhe gjuhën shqipe”, të cilën Gjon Kamsi nëpërmjet gazetës “Vullneti i Popullit”, maj 1930-tes, ja adresonte ministrit të arsimit të kohës Hile Mosi duke kritikue tendencat e përdorimit apo të futjes të fjalëve të hueja në gjuhën shqipe. Qysh në Itali, Gjoni u kujdes gjithmonë që varrit të heroit Luigj Gurakuqi të mos i mungonin lulet e fresketa dhe kur gjykata e Trani-t lroj si të pafajshëm atentatorin, ai në shenjë proteste për faljen e vrasësit vendosi mbi varrin e Gurakuqit për kthe ngjarjenj mbishkrim mbi një gur të skalitur (të marrë me qëllim në Trani), i cili sot (sipas familjarve)duhet të gjendet në Muzeun e Shkodrës.

Për fat, eshtrat e Luigj Gurakuqit u riatdhesuen në vitin 1957, e qysh prej asaj dite Gjoni ka qene vizitori dhe kujdestari i përhershëm i varrit të tij. Kurdohere mbi varrin e Gurakuqit kishte lule (mbasi një qiri ishte i ndalueme me u ndeze në diktature). Edhe në festen e 5 majit, varri i heroit ishte vend pelegrinazhit për Gjon Kamsin, i cili nën synin “vigilent” të komunistëve, lutej në heshtje për paqen e shpirtit të tij në amshim. Deri sa

vdiq, për Gjoni jeta dhe vepra e Luigj Gurakuqit ishte tema kryesore e bisedave të tija, me nxënës apo të rinj më të njohue e kureshtar të cilët kishin dëshirë të njihnin në detaje heroin.

“Vrasja e katërt e Gurakuqit”
Ku jane sot objektet apo reliket e Luigj Gurakuqit, të një prej burrave më të rëndësishëm të historisë tonë kombëtare, flaurur të atdheadashurisë, të luftëtarit të paepur për liri e pamvarsi? Pse heroi po lihet në heshtje? Pse askush nuk interesohet për ta rindërtuar shtëpinë e tij ashtu siç ishte?

Pse shteti, edhe pse pati shumë letra e kërkesa nga populli i Shkodrës, për vite të tëra neglizhoi e nuk ndërhyri për të mos e lënë të asgjësohej e të tjetërsohej shtëpia e tij që ishte muze dhe objekt kulture i mbrojtur me ligj?

Si mundet që objektet personale të Gurakuqit (ndër to edhe teshat e gjakosuna) të mbahen të mbylluna ndër magazinat e muzeut të Shkodrës ndërsa objektet e diktatorit kriminal zënë vendin kryesor në Muzeun Kombetar në Tiranë?

Si ka mundësi, ndërsa rinia sot më shumë se kurrë ka nevojë për leksione atdheadashurie e dinjiteti kombëtar, nuk gjendet një ambient (dhome apo sallon) ku të pasqyrohen vlerat e kësaj figure madhore si shëmbëlltyrë e shqiptarizmsë?

Ju lutem, mos e “vrisni” Luigj Gurakuqin për here të katërt. Ju lutem!

KRYQËZATA | E KOMUNISTEVE

HISTORISHKRIMI

Diskutimet për Luftën, si u zhduk termi “luftë civile”

Qëndrimi i Byrosë Politike ishte i prerë “për sa i përket luftës nacionalçlirimtare të hiqen termat “lufta civile” dhe çështja nuk u diskutua më gjatë, me përjashtim të diskutimit të Mehmet Shehut, i cili e përdori luftën civile si term...

NGA DR. SONILA BOÇI

Pjesa e dytë
(Vijon nga numri i kaluar)

Ndërsa ndryshimi i historisë së Lëvizjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme u përdor për legjitimimin e pushtetit të komunistëve, shkrimi i historisë së Luftës së Dytë Botërore do t’u shërbente tri qëllimeve: diskreditimit të kundërshtarëve politikë; mitizimit të lëvizjes partizane dhe krijimit e kultit të individit për drejtuesit komunistë.

Edhe diskutimet mbi historinë e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore ndoqën të njëjtën udhë si ato për ngjarje të tjera. Në ndryshim nga Lëvizja fshatare e Shqipërisë së Mesme, historianët nuk ishin shumë të gatshëm të kundërshtonin në lidhje me këtë pjesë historie. Në vitin 1959, dy ishin problematikat e ngritura nga historianët, të cilat gjetën kundërshtimin e drejtuesve komunistë: çështja e luftës civile dhe ajo e pushtetit. Një pjesë e historianëve, midis të cilëve Ndreçi Plasari, mendonin se në tekstin e historisë duhej të analizoheshin lufta civile mes gupeve rivale politike, si një fenomen që ishte zhvilluar krahas luftës nacionalçlirimtare. Sigurisht ajo ishte imponuar nga klasat shfrytëzuese të lidhura me armikun. Konkluzioni i përgjithshëm nga diskutimet e gjera që u zhvilluan ishte që “duhet përdorur vazhdimisht termi Lufta Nacionalçlirimtare dhe, kur të bëhen konkluzionet, të thuhet se kjo nuk ishte një luftë thjesht nacionale, por ajo ishte dhe një luftë klasash. Pra edhe luftë civile. Nuk mund të merret viti 1943 si data e fillimit të Luftës Civile, pasi qysh në fillim një pjesë e mirë e feudalëve dhe e borgjezisë shqiptare u vu në shërbim të okupatorëve. Pra duke luftuar okupatorët, luftohej dhe borgjezia dhe feudalët e vendit”.


Qëndrimi i Byrosë Politike ishte i prerë “për sa i përket luftës nacionalçlirimtare të hiqen termat “lufta civile” dhe çështja nuk u diskutua më gjatë, me përjashtim të diskutimit të Mehmet Shehut, i cili e përdori luftën civile si term: “për luftën civile dhe pushtetin popullor është [ka] një pjesë e madhe që duhet përpunuar”. Por ajo u rimor sërish në diskutim në vitin 1964, kur maketi i Historisë së Shqipërisë kthehet për t’u diskutuar për të tretën herë në Byronë Politike. Në këtë mbledhje Ramiz Alia, pasi bëri një vërejtje për mënyrën se si ishin trajtuar marrëdhëniet e PKSH-së

me Ballin Kombëtar gjatë luftës, vijon: “Është shumë i drejtë konkluzioni i bërë në f. 62 kur thuhet se shkaqet përse u shkaktua lufta civile [ishin], sepse Balli refuzoi të bashkëpunonte [me FNÇ], u bë me fashizmin kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare”. Ishte Enver Hoxha ai që tërhoqi vëmendjen duke thënë se duhej pasur kujdes me termin luftë civile, pasi “Balli dhe Legaliteti ishin mercenarë të okupatorit”. Ndërsa Mehmet Shehu mbronte idenë e karakterit të dyfishtë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare: antifashist dhe klasor.

Teksti i historisë i botuar nga Instituti i Historisë një vit më vonë, ndonëse nuk përmendte termin luftë civile konkludonte se “Duke kaluar plotësisht në anën e fashistëve gjermanë dhe duke marrë pjesë bashkë me ta në luftën e armatosur kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, reaksioni vendës i imponoi popullit shqiptar luftë luftë vëllavrasëse”. Ndërsa në tekste të tjera të mëvonshme ky përcaktim është hequr.

Rezistenca e shqiptarëve kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore është padyshim një ngjarje e rëndësishme në historinë e Shqipërisë. Por, në një analizë të mëtejshme, nga kjo periudhë buronte edhe legjitimiteti i drejtuesve të regjimit. Vendimet dhe veprimet e tyre të mëvonshme për të linçuar dhe marginalizuar nga pikëpamja politike dhe sociale ish-anëtarët e Ballit Kombëtar, Legalitetit dhe gjithë kundërshtarët politikë të luftës mbështetësit të fakti se ata kishin qenë kolaboracionistë. Ndërkohë historianët argumentonin se duheshin veçuar nacionalistët që kishin luftuar kundër pushtuesit, nga ata që kishin bashkëpunuar me të. Por një trajtim i tillë do t’i jepte disa kredite patriotizmi elitës politike dhe intelektuale shqiptare, gjë që nuk i përshtrajet politikës së komunistëve shqiptarë. Kjo ishte arsyeja që nuk mund të pranohet të shprehej hapur ideja e luftës civile, por kamuflohej pas shprehjeve “luftë klasash”, apo “luftë vëllavrasëse”. Në vazhde të këtij qëllimi politik nuk bëhej asnjë diferencë ndërmjet Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, apo Muharrem Bajraktarit dhe bajraktarit të Mirditës, Gjon Marka Gjonit, një bashkëpunëtor i vërtetë i pushtuesit gjerman.

Sa i takon çështjes se cili ishte momenti historik që duhej konsideruar si kyç i vendosjes së “pushtetit popullor”, historianët, por edhe anëtarët e Byrosë Politike, ishin të ndarë në përcaktimin e tij. Një pjesë mendonin se duhej konsideruar Kongresi i Përmetit, ndërsa të tjerë, 29 nëntorin 1944. Liri Belishova dhe Manush Myftiu ishin për 29 nëntorin, si data e vendosjes së pushtetit popullor, ndërsa të tjerët mbronin idenë e Kongresit të Përmetit, me argumentin se kjo ngjarje



ishte shënuar edhe në stemën e Republikës. Vulën çështjes ia vuri Enver Hoxha: “me Konferencën e Pezës u hodhën bazat e pushtetit popullor, në Përmet u konsolidua nga përfaqësuesit e popullit dhe më 29 nëntor është data e çlirimit”.

Shqetësim për anëtarët e Byrosë Politike ishin edhe përmasat që duhet të zinte në tekst Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pozicioni i tyre individual në të. Ndërsa më 1959 diskutimi u përqendrua në çështje konceptuale, në vitin 1962 ai mori një dimension krejt tjetër. Nuk u diskutuan as karakteri i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, as çështja e pushtetit. Anëtarët e Byrosë Politike kërkonin tashmë të glorifikonin rezistencën. Enver Hoxha porosiste që Lufta Antifashiste të dilte madhështore. Mehmet Shehu kujtonte se “kjo periudhë është periudha më e lavdishme e

Pjesë e procesverbalit të diskutimeve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror 1959, ku u diskutua për historinë e Luftës




Liri Balishova



Thoma Delihana



Stefanq Pollo



Pjesë nga procesverbalit i mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, 2 tetor 1964, në të cilën u diskutua vëllimi i dytë i Historisë së Shqipërisë

popullit, prandaj duhet punuar mirë". Kështu, ata kërkonin të glorifikoheshin disa beteja me të vërtetë të rëndësishme, si p.sh. ajo e Gjormit, të zmadhoheshin disa të tjera, si ndonjë luftim diku në Mirditë, dhe të anashkaloheshin disa fakte, si ai i mospjesëmarrjes së popullsisë së Veriut në këtë lëvizje. Njëkohësisht ata kishin prishmëri për të nxjerrë në pah rolin e tyre në këtë ngjarje të rëndësishme. Madje, me çështjen e personaliteteve të Luftës që do të përmendeshin në tekst, u hap mbledhja e Byrosë Politike. Historianët, sipas Hoxhës, kishin vendosur shumë emra personalitetesh. Ata e kishin saktë kur theksonin drejtimin kolektiv të Komitetit Qendror, por "ka disa emra që nuk mund të evitohen ..., prandaj mendoj që në tekst të vihet emri i shokut Mehmet, i shokut Hysni, i Myslim Pezës dhe i Spiro Moisiut që është

fakt historik që ka qenë komandant i përgjithshëm i UNÇ ... Emri im natyrisht të mbetet, por propozoj të hiqet nga teksti biografia ime". Përveç këtyre ai shton se duhet të ketë edhe një hierarki trajtimesh "të kihet parasysh që emri i Mehmetit dhe i Hysniut të jetë i ndryshëm nga formulimi që do të bëhet për Myslim Pezën dhe Haxhi Lleshin".

Pse ky ndryshim? Kur u diskutua teksti më 1959, Shqipëria ishte ende në orbitën sovjetike. Propaganda zyrtare ishte e përqendruar të përmendte rolin e jashtëzakonshëm të Ushtrisë së Kuqe në fitoren botërore kundër Boshtit nazifashist. Gjithashtu, drejtuesit komunistë ishin të detyruar të përfshiheshin në fushatën e iniciuar nga Hrushovi kundër kultit të individit të udhëheqësve. Kjo ishte arsyeja, në këndvështrimin tim, që këto çështje nuk u ngritën në diskutimin e parë. Në vitin 1962, situata politike në Shqipëri kishte ndryshuar. Prishja me Bashkimin Sovjetik ishte zyrtarizuar. Drejtuesit duhet të gjenin mjete të reja propagandistike për të motivuar popullsinë. Lufta ishte shpëtimi i tyre. A nuk ishin orientuar këta udhëheqës drejt gjatë rezistencës? A nuk e kishin drejtuar popullin drejt fitoreve dhe rrethuar Shqipërinë në radhët e vendeve fituese? Duke glorifikuar rezistencën, ata mund t'i tregonin popullit se ende po merrnin vendimet e duhura dhe rruga që po ndiqej ishte ajo e drejtë.

Në këtë proces, mesa duket faktet historike, nuk ishin gjithaq të rëndësishme. Në këtë proces, mesa duket faktet historike, nuk ishin gjithaq të rëndësishme. Në vitin 1955, Tuk Jakova kishte guxuar të kritikonte paraqitjen e ngjarjeve historike të Luftës në tekstet, muzetë dhe propagandën zyrtare, por ai e kishte paguar këtë me burgimin e tij. Vetë Enver Hoxha u kishte kujtuar me heret historianëve se "ne rrezuam një pushtet të tërë, kapitalizmin dhe feudalizmin, prandaj asgjë nuk na tremb të rrezojmë e të hedhim poshtë disa teza historike që nuk janë të drejta". Madje, ato mund të ndryshonin sipas kriterëve politike. Sa për ta ilustruar mund të përmendim një diskutim mbi personalitetet që do të përmendeshin në historinë shumëvëllimshë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Redaksia e hartimit të këtyre vëllimeve i paraqiti, përveç të tjerave, edhe kriteret e përzgjedhjes së personaliteteve që përmenden në tekst. Sipas tyre, do të ishin pjesë e tekstit të gjithë anëtarët e plenumit të KQ të PKSH të vitit 1943, që përmenden edhe në Historinë e Shqipërisë. Të tjerët, si Koçi Xoxe, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Bedri Spahiu, Sejfulla Malëshova etj do të përmendeshin vetëm kur të kritikoheshin sjellja dhe veprimtaria e tyre. Nga anëtarët jo komunistë të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar do të përmendej vetëm Abaz Kupi. Ndërsa për anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ, pjesëmarrësit në konferenca e kongrese, komandantët e çetave, batalioneve, brigadave e divizioneve partizane do të evidencoheshin vetëm ata që "kanë qenë konsequentë në veprimtarinë e tyre revolucionare", pra ata që nuk ishin dënuar nga regjimi.

Ndikimi që trashëgimia e kujtesës së ndryshuar ka në shoqërinë e sotme shqiptare

Sig u analizuara gjerësisht më lart, në shtetin socialist e shkuara lexoheshin nga e sotmja. Por e tashmja ishte shumë

e paqëndrueshme dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Drejtuesit, planet, madje dhe aleatët shkonin dhe vinin. Në këto rrethana dhe e shkuara duhet të ndryshonte.

Të pakta janë shtetet komuniste që kanë bërë kthesa aq drastike në politikën e tyre të jashtme dhe kanë nxjerrë aq grupe armiqësore sa Shqipëria. Një situatë e tillë ndikoi padyshim në propagandën komuniste dhe në perceptimin apo në tryshninë që ushtrohej në kujtesën kolektive të shqiptarëve. Çfarë duhet të mendonim dhe kë duhet të besonim shqiptarët: Enver Hoxhën e vitit 1946, kur thoshte se pa Jugosllavinë e Titos, Shqipëria nuk do të ishte çliruar, Enver Hoxhën e vitit 1951, kur thoshte se ishte Bashkimi Sovjetik ai që ndihmoi në çlirimin e Shqipërisë, apo më shumë akoma Enver Hoxhën e vitit 1961 që thoshte se Shqipëria ishte çliruar tërësisht me luftën vetëmohuese të bijve të saj më të mirë? A duhet të besonim shqiptarët se Mehmet Shehu, kryeministri i Shqipërisë prej gati tre dekadash, ishte besnik i partisë, siç ishte thënë vazhdimisht deri në vitin 1981, apo ishte agjent i një numër të konsiderueshëm agjenturash të huaja, siç thoshte Enver Hoxha në librin e tij "Titistët"?

Rezultati i këtij procesi ishte krijimi i një konfuzioni të madh në mendjen e njerzëve. Por, si një mekanizëm mbrojtës, shoqëria mësoi të mos bënte pyetje. Gjërat pranoheshin ashtu siç thuheshin nga propagandistët partiake. Dikush mund të argumentojë se kjo situatë kishte dhe anën e saj pozitive, sepse në këtë rast ideologjizimi nuk mund të ndryshonte tërësisht kujtesën e individëve.

Në të kundërtën, unë mendoj se një proces i tillë, i mbështetur në një propagandë të paqëndrueshme, sipas së cilës rebelët bëheshin heronj dhe heronjtë shndërroheshin në tradhtarë brenda natës; ku individit i kërkohet të dilte madje dhe mbi identitetin personal të tij, do të çonte në një mungesë identiteti. Gjë që do të çonte në paqëndrueshmëri dhe devijime sociale. Kjo u vu re qartë, kur shqiptarët kanë dyert e izolimin komunist dhe për herë të parë dolën në botën e lirë. Sjellja e tyre në shtetet perëndimore të Evropës ishte shembulli i njeriut të cilit i janë imponuar rregulla strikte, por jo përgjegjësi individuale.

Në një analizë afatgjatë, gjithë procesi devijoi marrëdhëniet e shoqërisë me historinë, veçanërisht me historinë e shkruar dhe instaloi një kujtesë të shformuar kolektive mbi të shkruarën. Në këta 24 vjetët e fundit, historianët kanë pasur kohën e mjaftueshme për të konsultuar dokumentet e shkruara vendase dhe të huaja dhe të ridimensionojnë historinë e kombit. Por, disa reminiscenca të së kaluarës, nuk e lehtësojnë procesin. Historia ende vazhdon të përdoret për interes politikë të ditës. Ndryshimet e politikës, edhe pse jo të drejtpërdrejta, vazhdojnë të jenë një problem për historianët e sotëm, por jo i vetmi. Procesi e dekonstruktimit të miteve po rezulton mjaft i vështirë, kjo edhe për shkak të mbajtjes gjallë të tyre nga segmente të caktuara të veshura me pushtet. Në këtë këndvështrim, vështirësia më e madhe është raporti i historianit me publikun, i cili disa skeptik ndaj profesionistëve, i indoktrinuar në njërën apo tjetrin krahu nga politika dhe njerëz që i shërbejnë asaj, dhe, duke mos njohur burimet dhe aspektet teorike, po jeton një krizë të vërtetë besimi.

BESIMI | NDËR SHQIPTARËT

Arbëria-Shqipëria, si hapësirë e Krishtëritimit

Një historik i gjurmëve të krishtëritimit nga lindja e tij dhe përhapja në zonat ilirike, përbalja me islamizimin, dhe sfidat e e dy shekujve të fundit, nga dhunimi ekstrem në regjimin komunist deri në ringjalljen e besimit pas viteve '90...

DR. DOM NIKË UKGJINI

Doc. Institutin Filozofike dhe Teologjik Shkodër

Ngjarja më e rëndësishme e në kohën antike, e cila ka gjurmë të pashlyera në botëkuptimin e njeriut si krijesë e Hyjit, ishte padyshim dalja në skenë e besimit të krishterë dhe përhapja e tij në popull. Ky besim monotheist i themeluar nga Jezu Krishti i hodhi rrënjët e veta në trevat iliro-shqiptare, që në kohën apostolike.

KRISHTËRIMI NË ILIRI

Ngjarja, e cila ndryshoi botën e Ilirikut, ishte pranimi i Krishtëritimit të sjellë nga apostujt (nxënësit) e Jezu Krishtit. Bazë mbështetëse dhe arsytim, pohimprovë e gjallë për këtë janë vetë fjalët e shën Palit: "Kështu predikova që nga Jerusalemi dhe përreth deri në Ilirik, duke kryer detyrën e shpalljes së Lajmit të Gëzuar mbi Krishtin" (Rom 15, 19, rreth vitit 66). Shën Pali i shkruan Titit që të shkonte në qytetin e Nikopojës, në të cilin ai kishte vendosur të dimëronte (Tit. 3, 12). Ishte ky qyteti më i njohur në Epir prej ku Shën Pali në pranverë dërgoi Titin në Dalmaci (2 Tim 4, 10).

Nga ana e tjetër, qytetet e Epirit të ri, Durrësi dhe Apolonia (Polana e sotme pranë Fierit), ishin portet kryesore, të cilat, nëpërmjet rrugëve të njohura romake, Via Egnatia dhe Via Appia (ato bashkoheshin në lumin Shkumbin) lidhnin Romën me Bizantin, nëpër të cilin, siç na tregon Besëlidhja e Re, shpeshherë kanë udhëtuar nxënësit e Krishtit. Kështu, gati me një siguri të plotë, mund të pohojmë, se Shën Pali dhe nxënësi i tij Tit, kanë vizituar gjatë udhëtimeve të tyre edhe Ilirikun.

Sipas dëshmiave të kohës, krishtërimi në trevat iliro-shqiptare u predikua pikërisht: në Epirin e Vjetër nga Shën Pali dhe Shën Andreu; në Epirin e Ri nga Shën Pali dhe nxënësi i tij Tit; në Dardani, shën Matia dhe Praevalitan, e cila ka qenë një provincë mjaft e zhvilluar, nga është kaluar nga jugu për në Dalmaci, mendohet të ketë unguillëzuar Shën Luka, Shën Pali dhe Tit, të cilët sipas dokumenteve historike, kanë qëndruar në Dalmaci.

Mbi veprimtarinë e Shën Lukës unguilltar në Dalmaci, flet Shën Epifani, i cili ka vdekur në vitin 403. Shën Pjetër Damiani, i cili u lind në vitin 1007 në Ravenna, thekson se si

Shën Pali ka vizituar tërë Ilirikun. Për këtë J. Zeiller fjalë për fjalë kostaton: "fillimet e krishtëritimit në Ilirik datojnë që nga epoka apostolike". Nga ana tjetër, po përmendim edhe martirët e parë nga këto vise: Shën Astistin në Durrës në fillim të shek. II, shën Terinin në Butrint (Buthrotum) në shek. III, pastaj martirët dardanë, Florin dhe Laurin në Ulpijanë tek Graçanica e sotme, të cilët dhanë jetën e vet gjatë kohës së mbretit Adrian (117 – 138) e të tjerë.

Ilirët duke e pranuar fenë e krishterë që nga fillimi i tij, u radhitën kështu ndër popujt biblikë të lindjes. Lajmi i gëzueshëm i komunikuar drejtpërdrejtë në truallin ilir, nga goja e apostujve, u bë një dëshmi e rëndësishme dhe nisje e re e një folozofie mendore-jetësore – kulturre e këtij populli të privilegjuar nga Zoti.

ORGANIZIMI I KISHËS POSAPOSTOLIKE

Dëshmi të tjera historike dhe arkeologjike na flasin për zhvillimin dhe organizimin e kishës posapostolike: në vitin 58 gjejmë emrin e ipeshkvit të parë të Durrësit (Epydamus), shën Caesari; në vitin 100 emrin e ipeshkvit të dytë, po ashtu të Durrësit, shën Astisi martir.

Burimet historike në vazhdim na flasin për themelimin e dioqezeve të tjera nga shek. III e në vazhdim, të organizuara nëpër qytete si: Ohrid (Ohridana), Shkup (Scopiensis), Ulpijanë (Ulpianenses), Nish (Naissitani), Nikopol (Nicolitani), Apollonia (Andrianapolia), Amantia (Ploça), Vlorë (Aulon), Butrinti (Buthrotum), Fenice, Elbasan (Scampa), Saranda (Onchesmo), Himara (Chiamara), Shkodër (Scodrensens), Tivari, (Dokleatium, Antivari), Drisht (Drivasto), Ulqini (Ulcinium) etj.

Në vazhdim e këtyre dëshmiave mbi fillimin dhe organizimin e kishës, na flasin edhe etërit kishtarë të shek. IV – V, si: shën Gregori i Nishit (nga Naissusi, 334 – 379). Pastaj djitari dhe shkencëtari i madh ilir, shën Jeronimi (347 – 420) nga Stridoni, i cili, mes të tjerash, thotë: "Krishtërimi është përhapur në të gjitha vendet (...) me Tomën në Indi, me Pjetrin në Romë, me Palin në Ilirik, me Andrenë në Abah".

Nga historia e përgjithshme e Kishës, është e njohur se ipeshkvinjtë e gjithë Ilirikut merrnin pjesë aktive në koncilat e Kishës, duke filluar që nga Koncili i Parë Ekumenik i Nikesë, në vitin 325 e deri në Koncilin e

Shtatë Ekumenik, mbajtur në vitin 787 po ashtu në Nike.

Në trevat shqiptare në shekujt IV – VII, në katër provincat e sipërpërmendur, funksiononin metropolitë e Shkodrës, Shkupit, Durrësit dhe Nikopojës. Këto metropoli kishin përkatësisht 3, 5, 8 e 9 dioqeza vartëse (suffragane). Ipeshkvinjtë e provincave mblidheshin periodikisht, nën kryesinë e metropolitit, në sinodët provinciale. Kurse metropolitët merrnin pjesë në Koncilat Ekumenike, ku diskutoheshin probleme që kishin të bënin me dogmën e krishterë, etj.

Ndonëse politikisht trevat shqiptare bënin pjesë në Perandorinë e Lindjes, nga pikëpamja kishtarë ato u vunë nën autoritetin e Selisë së Shenjtë. Për t'i forcuar lidhjet e tij me kishën e këtyre vendeve, Papa që nga viti 412 caktoi një vikar (mëkëmbës) të përgjithshëm me qendër



Kisha e vjetër e shek XIII dhe e re 1936 në Vau të Dejës

në Selanik, që kishte, përveç të tjerash, për detyrë të shuguronte ipeshkvinjtë e Ilirikut, të kryesonte sinodat provinciale dhe t'i zgjidhte grindjet fetare, përveç rasteve të rënda që ishin në kompetencën e Papës. Më vonë, për shkak të përpjekjeve të Konstandinopojës për t'i shkëputur dioqeza të Ilirikut Lindor nga Roma në fillim të shek. VI, Selia e Shenjtë, krahas Selanikut po në këtë shekull, ngriti një vikariat Apostolik të dytë në Shkup të quajtur Justiniani i Parë (Justiniana Prima).

Emrat e shumë ipeshkvine, të cilësuar si të provincës së Prevalitanës, të kryedioqezes së Shkodrës, Dioklesë, Lezhës dhe të Risanit (në gjirin e Kotorrit) përmenden në harkun kohor prej mesit të shekullit IV e deri në fillimin e shekullit të VII. Letërkëmbimet e



Katedralja e Shkodrës e shndërruar në xhami

ipeshkive të Prevalit me Selinë e Shenjtë na japin të dhëna me interes mbi qëndrimin e klerit të kësaj province ndaj debatëve të njohura teologjike në lidhje me herezitë që lindën dhe u zhvilluan në gjirin e kishës së krishterë. Me këtë rast mësojmë edhe disa nga emrat e ipeshkive të cilat deri me ardhjen e sllave i udhëheqnin dioqeza, si: kryedioqezen e Shkodrës, Bassus (387) Senecio (431) e deri tek i fundit Constantinus (602) dhe dioqezes së Dioklesë, Evandrus (450), dhe Paulus (602). Sllavët paganë dhe dominimi i tyre në trevat shqiptare

PUSHTIMET SLLAVE

Pas pushtimit të Avarëve dhe Sllavëve në mesin e shek. VII si popuj paganë, nuk kemi shënime për fatin e Kishës në trevat iliro-shqiptare deri në koncilin e Duvnos (Delmitanum) në vitin 877 dhe fillimit të pagëzimit të sllave po në këtë shekull (IX), ku Bregdeti Adriatik ishte i ndarë në Dalmacinë e Poshtme dhe atë të Sipërme. Dalmacia e Sipërme shtrihet nga Duvno (Delmitanus) deri në Durrës me metropoli Dioklenë, e cila kishte nën juridiksionin e vet dioqeza: Kotorrin, Budvën, Tivarin, Ulqinin, Shasin, Shkodrën, Drishtin, Pultin, Bosnjen, Travunin dhe Zahumljen. Më ndarjen e kishës Lindje dhe

Perëndim në vitin 1054, përkohësisht u ndalua hovi i pushtimeve sllave dhe njëherazi ra fuqia e Bizantit ortodoks. Këtë ndryshim e shfrytëzoi Diokleatë dhe me Mihail Vojslavleviqin (1052 – 1081), me ndihmën e Papës, Gregorit VII (1073 – 1085), në trevën e Praevalitanës së dikurshme, krijuan shtetin e pavarur të Dioklesë, me një shtrirje të gjerë të juridiksionit kishtar katolik. Mbreti i Dioklesë, Konstantin Budini (1081 – 1101), për shkak të hovit të ortodoksisë, në vitin 1089 arriti të merrte pëlqimin e anti-papës Klementit të III, ku ridinenshoje metropolia e dikurshme e Dioklesë me emërtimin e kombinuar: Kryedioqeza metropolitane

Diokleato – Tivarase me qendër në Tivar dhe nën vehte kishte 9 dioqeza: Kotorrin, Ulqinin, Shasin, Shkodrën, Drishtin, Pultin, Serbisën, Bosnjen, Trebinje dhe të gjitha kuvendet dhe abacitë përbrenda këtij territori. Në trevat iliro-shqiptare, ashtu si dhe në bregdetin dalmatin, që nga shek. IX deri në shek. XIV, si kundërpërgjigje përhapjes së ortodoksismit, lulezuan urdhëratë e vjetër rregulltarë, kryesisht ai benediktin dhe u ngritën një numër i madh i abacive dhe kuvendeve, që me siguri ushtruan ndikim të madh në jetën fetare të vendit. Ndër abacitë më me ndikim ishin, abacia e Shën Marisë në Rataci, në afërsi të Tivarit; ai i shën Nikollit buzë lumit Buna; Shirqit dhe Bakut në breg të Bunës; i të Shëlbuarit në Rubik; Shën Prenës në afërsi të Kru-



Kisha katedrale e Kallmetit, në Lezhë, e fund shekullit XIX

jës; shën Aleksandrit në Orosh të Mirditës, etj. Shfaqja e parë e françeskanëve në Shqipëri, sipas traditës, ka të bëjë me vetë shën Françeskun. Mendohet se i varfëri i Asizit, gjatë kthimit të tij nga Siria, kishte ndaluar në Lezhë. Aty kishte ngritur kuvendin e parë në Shqipëri. Kjo traditë lidhet me mbishkrimin mbi arkitravin e Kishës Françeskane në Lezhë, në të cilin shkruhet: Hoc templum Fratorum Minorum aedificatum est anno 1240. Megjithatë dyshohet në autenticitetin e këtij mbishkrimi. Përndryshe kuvendet e françeskanëve kanë qenë shpërndarë gjatë bregdetit shqiptar mes Tivarit dhe Durrësit. Shteti i parë homogen shqiptar llogaritet të ketë qenë Principata e Arbërit në shek. XI me kryeqendër Krujën. Kurse fiset e tjera shqiptare kanë qenë të shpërndara në provinca të tjera përreth. Që shqiptarët në Praevalitanë dhe më gjerë, ishin banorë të ungjillëzuar mirë, të qytetëruar dhe faktorë të rëndësishëm në Gadishullin Ballkanik, na e dëshmon në shkrimin e tij kryepeshkvi i Tivarit, dominikani francez, Guillelmo Adae (1324 – 1341), i cili, duke i kundërshtuar pushtimeve të mëdha ortodokse të mbretit të Serbisë, Stefan Dushanit, në shek. XIV mbi tokat shqiptare dhe më gjerë, në vitin 1332, ndër të tjera thotë: "shqiptarët janë të fesë katolike... megjithatë shqiptarët kanë një gjuhë krejtësisht të ndryshme e tjetër nga ajo latinisht, megjithatë në të gjitha librat e tyre kanë në përdorim alfabetin latin". Ardhja në pushtet e Stefan Dushanit shënon pushtimin e trojeve shqiptare nga qyteti i Kotorit deri në Selanik. Në anën tjetër, krijon një armiqësi të madhe në marrëdhëniet mes Kishës katolike dhe Kishës sllavoortodokse autoqefale Serbe, krijuar që në vitin 1219. Ky antagonizëm u kulmua me miratimin e kodit të vitit 1349, të quajtur "Kodi i Dushanit", i cili i cilëson katolikët si "jeres latin", kërkon kthimin e atyre që kishin kaluar në fenë katolike, duke ndaluar rreptësisht ripagëzimin e ortodoksve në katolikë. Ndërhyn në martesat e përziera, bën presion të madh në meshtarët katolikë, duke caktuar nga një prift sllavoortodoks që të kremtonin meshë pranë tyre në kishat katolike, zaptin objektet dhe kishat katolike, duke i jetësuar për kishën sllavoortodokse. Mbreti, si kundërpeshë kryedioqezës së Tivarit në vitin 1346, krijon patriarkanën e Pejës, si qendër të sllavoortodoksismit. Pas vdekjes së Stefanit Pushtues, erdhi deri të shkatërrimi i Perandorisë pushtuese serbe dhe filloi dalja në skenë e dinastisë shqiptare të Balshajve (1360 – 1421) me kryeqendër Shkodrën, e cila arriti për herë të parë t'i bashkonte territoret reale të shqiptarëve nga Zeta (Dioleka) në veri deri në Selanik (Thesalonik) në jug dhe Justiniana e dytë (Justiniana Secunda) në lindje.

Sprovat e Ungjillëzimit gjatë Perandorisë osmane në shek. XV – XX

PUSHTIMET OSMANE

Sundimet turko – osmane në Shqipëri e kanë zanafillën nga beteja vendimtare e cila u zhvillua në Fushë – Kosovë në vitin 1389, ku koalicioni i popujve të krishterë të përbërë nga Serbët, shqiptarët, hungarezët, boshnjakët etj. pësuan disfatë. Kjo betejë u dha hov turqve që të fillonin fazën e re të pushtimeve, të udhëhequr nga Murati II Pushtues. Në këtë kohë tragjike për të krishterët e Ballkanit dhe të Evropës, përballë pushtuesve qëndronte njeriu i bekuar, "Atlet i Krishtit", siç e quajti papa Kalisti III, i pavdekshmi, matjani Gjergj Kastrioti (1405 – 1468), i cili deri në vdekje me fuqinë hyjnore, kishim për të thënë, ndaloi hovin e pushtuesve. Pas vdekjes së tij, sikur një korb i zi zaptoi tokat shqiptare. Historia shënon se pas rënies së Krujës (1478), dorëzimit të Shkodrës nga Venedikasi (1479), rënies së Durrësit (1501) dhe Tivarit si kryedioqezë metropolitane (1571), çdo gjë për trevat shqiptare mori fund. Me këtë turqit përfunduan pushtimin e qyteteve të Shqipërisë dhe Malit të Zi të sotëm, që rezultoi me ekodin e madh të shqiptarëve të krishterë në brendësi, në viset e thella malore të Alpeve Shqiptare si dhe jashtë në Mbretërinë e Napolit, në krahinat e Kalabrisë e të Sicilisë, Dalmaci dhe rajonet e Venedikut. Normalisht së bashku me popull shkuhan dhe ungjillëzuesit.

Pushteti turk, pasi u përfundua në këto vise në fund të shek. XV – XVI, për të sunduar më me sukses, ndërtoi edhe pushtetin e vet administrativ, ekonomik dhe ushtarak. Kështu formoi njësinë administrative të sanxhaqeve.

GJENDJA NË KISHËN KATOLIKE NË SHEK. XVI-XVII

Pas konsolidimit të pushtetit turk dhe urdhërit të Sulltan Selimit II nga viti 1569, me të cilin urdhërohet që në tërë Perandorinë, përveç në Konstantinopol, Brusi dhe Adrianopolis, të konfiskohen të gjitha pronat e kishës, gjendja në kishën katolike ndërshqiptare ishte tejte e keqësuar. Turqit e një perandorie islame morën të gjitha pronat dhe të mirat e kishave. Nga ana tjetër, nëpër rezidenca ipeshkvore dhe famullit, rritet numri i katedraleve dhe i kishave të shndërruara në xhami si dhe numri i katolikëve që kaluan në islam. Bëhet kështu edhe më e dukshme dita ditës zgjerimi dhe shtrirja gjithnjë më e madhe e islamizimit.

Pushtimet osmane përveç shkatërrimit të kuvendeve dhe abacive të ndryshme të kohës antike, nga skena kishitare kishin zhdukur edhe dioqezat e vjetra të kohës antike dhe mesjetare: Shasin, Ulqinin, Drishtin, Balshin, Arbërin etj. Kisha katolike ndërshqiptare në shek. XVI kishte këtë organizim: Kryedioqezën e Tivarit më sufragane të veta,

Shkodrën, Pultin, Sapën, Lezhën; Kryedioqezën e Durrësit dhe Kryedioqezën e Shkupit.

Sipas raportit të kardinal Santorit nga 15 korriku i vitit 1590, botuar në "La civiltà cattolica", ipeshkvinjtë në bazë të urdhërit të pushtetit turk, nuk guxonin t'i udhëhiqnin më dioqezat nga qendra e deriatëhershme, por këtë duhej ta bënin nga ndonjë famull përreth. Misionarët, si edhe shumë të tjerë, erdhën në mesin e besimtarëve shqiptarë për shkak të mungesës së priftërinjve dhe rregulltarëve vendas, si dhe të nevojës tepër të madhe të ruajtjes së fesë katolike, e cila, nën terrorin turk, dobësohej çdo ditë e më shumë, pasi katolikët masivisht kalonin në islam. Kështu, duke parë këtë gjendje, Kongregacioni për përhapjen e fesë (De Propaganda Fide) – themeluar në vitin 1622), me kërkesën e ipeshkvit të Sapës, imzot Gjergj Bardhit, filloi të dërgojë në Shqipëri që nga viti 1634 misionarët, françeskanët reformatore nga Italia, të cilët në Shqipërinë e pushtuar vinin nëpërmjet Venedikut.

KRYEDIOQEZA E TIVARIT

Kryedioqeza e Tivarit, e cila figuron si dioqezë që në shek. VI, e mban këtë titull që nga viti 1089 dhe, sipas I. Markoviqit, D. Far-



Abacia e Shënjtërit e shek XIII

latit, S. Stojanoviqit, edhe më herët (1067). Kjo kryedioqezë e cila gjatë pushtimeve osmane kishte dioqezat sufragane të saja Shkodrën, Lezhën, Pultin dhe Sapën ka mbajtur të ndezur gjatë shumë shekujve pishtarin e krishterimit në rrëmujën e madhe mes Perëndimit dhe Lindjes. Në kohën kur ishte faktor i rëndësishëm dhe vendimtarës, ka qenë shumë e njohur dhe ka gëzuar një autoritet e zë të madh duke korrur edhe suksese, por në kohërat e vështira, të errëta dhe të gjakosura, etnikisht të përzier (elementi shqiptar me atë sllav), asaj u desh të luftonte për ekzistencë duke mbijetuar nganjëherë edhe me praninë e vet simbolike.

Me rënien e Tivarit nën sundimin e

turqve, më 6 gusht të vitit 1571, nga qyteti do të zhduken, jo vetëm katedralja kushtuar Shën Gjergjit, të cilën Turqit në vitin 1579 e shndërruan në xhami, por të gjitha kishat e kuvendet ndërtuar në mesjetë. Përndryshe territori nga Ulqini deri në Perast (Boka e Kotorrit), e cila deri para pushtimeve quhej "Albania Veneta" (Shqipëria Venedikase), në burimet venedikase edhe pas pushtimeve turke është quajtur më të njëjtin emër.

Popullsia katolike zvogëlohet në numër për shkak të ikjeve të tyre, vriten nga turqit apo dhe pranonë fenë e sunduesve të vet – islamit dhe më vonë sllavoortodoksismin.

Vetëm në vitin 1610, sipas raportit të Selisë së Shenjtë, arqipeshkvit të Tivarit, Marin Bizzit (1608 – 1624), përkatësia fetare e popullsisë, për shkak të ardhjes së popullsisë nga Mali i Zi dhe vendosjes, në Tivar u ndryshua plotësisht, kështu që pranë 290 shtëpive myslimane, sipas dokumenteve, kishte 210 shtëpi të krishtera, shumica e të cilave ishin sllavoortodokse. Numri i katolikëve zvogëlohet në mënyrë drastike në kohën e administrimit (15 vite) të ipeshkvit të Shkodrës, Pjetër Bogdanit (1656-1677). Në vetë qytetin e Tivarit në këtë kohë nuk kishte asnjë familje katolike, ndërsa kishte rreth 300 shërbëtorë katolikë dhe robër nëpër shtëpitë e turqve, kurse në gjithë kryedioqezën kishte 8 fshatra (famulli) katolike me 279 familje dhe 2.400 frymë. Katolicizmi në fakt gjendej mes dy zjarreve, mes sllavoortodoksismit dhe islamit. Selia e Shenjtë u përpoq të përmirësonte këtë gjendje, qoftë me bisedime që bëri me vlladikët sllavoortodoksë, qoftë me turqit nëpërmjet lidhjeve të arqipeshkvinjtë të Tivarit, psh, me arqipeshkvin Bizzi, Andrea Zmajeviqin dhe disa të tjerë, por pa ndonjë sukses të dukshëm dhe të qëndrueshëm.

Sipas raportit të Selisë së Shenjtë, dom Shtjefën Gasprit, arqipeshkëvit të mëvonshëm të Durrësit në vitin 1671, kjo arqipeshkëvi kishte 7 priftërinj, 367 shtëpi me 2.270 frymë. Në këtë statistikë është përfshirë edhe Dioqeza e dikurshme e Budvës (Budua), që tani cilësohej si vikariat apostolik.

DIOQEZA E SHKODRËS

Në dioqezën e Shkodrës, e cila ekziston nga koha më e vjetër (387), në pjesën e dytë të shekullit XV gjejmë shënimin se kishte 26 familje të islamizuara. Kisha e parë të cilën Turqit pas pushtimit të kalasë së Shkodrës (1478-1479) e shndërrua në xhami e cila ndodhej jashtë mureve të kalasë, është kisha "Zoja e Këshillit të Mirë" (Madonna del Buon Consiglio) të cilën Turqit në vitin 1478 ia dhanë emrin xhamia e Sulltan Mehmetit II. Më vonë, Turqit edhe një kishë tjetër, e cila gjithashtu ndodhej jashtë mureve të kalasë, e bënë xhami dhe i dhanë emrin "Kasem Ali Sulltan". Pas rënies përfundimtare të Shkodrës në vitin 1479, edhe kisha katedrale e Shën Shtjefnit martir, e cila gjendej brenda kalasë, pësoi të njëjtin fat si dy kishat e mëparshme.

Kështu pas rënies përfundimtare të Shkodrës, edhe pas përpjekjeve të dominikantit p. Bartolit nga Epiri, që populli, edhe pse tani nën zgjedhjen e pushtuesit të qëndronte në vazhdimësinë e tij, ai nga frika u shpërndam në të katër anët. Ikën më të madhe. Vetëm në Venedik ikën 3.300 katolikë.

Sipas raportit Shtjefën Gasprit, dioqeza e Shkodrës në vitin 1671, ka pasur 2097 shtëpi me 19.293 frymë; Lezha, 917 shtëpi katolike me 7.025 katolikë; Pulti 581 familje katolike me 4.045 frymë; Sapa, kishte 1.075 shtëpi katolike me 9.226 frymë; Kryedioqeza e Durrësit, e cila figuronte si dioqezë nga koha apostolike, kishte 1056 shtëpi dhe 13.650 katolikë dhe Shkupit, kishte 268 shtëpi katolike me 2169 besimtarë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

MUZIKANTI | LIBRI

Një libër odeon për bardin e madh të çiftelisë

NDUE DEDAJ

Në 80-vjetorin e lindjes së "Artistit të Popullit" Ndue Shyti, "Nderi i Kombit"



autori, duke na krijuar plotërinë e kësaj figure emblematike të muzikës popullore. Është pohuar nga bashkudhëtarët në koncertet jashtë vendit, se atij i ishte ndaluar t'i binte çiftelisë pas mesnate, pasi ashtu do ta zbardhte drita mbi vegël. Vërtet folku ka befasisë e veta, jo më kot në Suedi artdashësit e huaj kishin thënë për të se ky artist na hipnotizon me meloditë e tij, por a ishte e nevojshme gjithë ajo punë kur talenti i tij ishte i pashoq? Duket se një gjeni krijues nuk mund të jetë vetëm me atë qelizën zanafillore, talentin, por dhe me punën deri në vetëflijim. Kësaj i mëshon dhe autori i monografisë, si për të na thënë për të njëmijetën herë, është puna që e bën artistin.

Ky botim i tij erdhi pas disa sprovash në fushën e monografive për artistë të folkut të Veriut, si rapsodin e njohur Frrok Haxhia, instrumentistin popullor Mark Nikolla, njeriun erudit Pal Nikoll Marku, themelues i shërbimit sinoptik shqiptar në Tiranë, më vonë i bibliotekës

shkencore të naftës në Kuçovë etj. Ndue Shyti e kishte fort për zemër njeriun që do të shkruante monografinë e tij, por aspak për këtë qëllim, por që 15 vite më parë. Me Mark Mesulin, thotë ai, njihemi pa qenë partië, si të flasë për një kohë të largët të njerëzimit, si me thënë përtej politikës.

"Ka qenë kryetar i komunës së Gjegjanit, në vitet 2000, kur erdhi në shtëpinë time në Durrës, ai nuk e këqyri që unë isha demokrat e unë nuk e këqyra që ai ishte socialist. Më ka ardhur dhe në fatkeqësinë e humbjes së djalit, në anën njerëzore më asht tregue vëllat e shkuë vëllaut.

Ai ka kuptuar se gjithnjë vlerësimin e kam marrë vetëm prej artit dhe kjo asht arsyeja që unë e besoj në ato që shkruan për mua." Por edhe pse kishin këtë raport ndjesor e miqësor të ndërsjelltë mes tyre, deri vonë nuk kishin ndërmend të venin të ky libër, Ndoi mbase mendonte se nuk ishte dikush i ngëshëm t'ia hynte një libri kushtuar tij, Marku se e dinte sa punë kishte një monografi e tillë, për më tepër kur punë kësdodore nuk gjejnë fort

mbështetje nga ata që e kanë për detyrë të krijojnë lehtësirat e nevojshme. Por më në fund Ndoi u bind që të dëshmonte mbi jetën e tij artistike, ku pas kësaj, autori e ka intervistuar me orë e ditë të tëra në shtëpinë e tij në Durrës, ka gurmuar në arkiva e biblioteka çdo të dhënë e detaj rreth jetës artistike të artistit virtuoz, ka shfletuar botimet dhe shtypin e kohës, ka thirrur në "ndihmë" një varg specialistësh të fushës së muzikologjisë nga më të njohurit e vendit, për të kumtuar rreth veçorive krijuese të institutit Ndue Shyti, gjë që e ka bërë librin e tij më solid e profesional. Është interesante se ai shihet si atëherë si sot, pa kërkuar t'i rrëzojnë diçka nga krijimtaria e tij, kinse të natyrës ideologjike, siç ndodh me këngëtarët, pasi meloditë e tij ishin krejtësisht jashtë "ideologjikës" dhe socrealizmit.

Falë lëndës së bollshme që Mesuli ka sjellë dhe mbarështrimit të saj, lexuesi kupton se ky artist i Popullit (me gërmë të madhe) kur rrëfen për veten, thotë gjithmonë më pak se sa të tjerët, mjeshtrit e mëdhenj të muzikës, thonë për të. Autori ka bërë një punë skrupuloze me këtë botim, duke i bërë nder bibliotekës së tij të dijes dhe asaj studimore, që në këto dhjetë vitet e fundit ka krijuar një profil të admirueshëm. E kemi shënuar dhe më parë se ky studiu posedon një bibliotekë të pasur që është identiteti i tij, që rrallë mund ta gesh tjetërkund në male, të cilën e trajton si një krijesë të gjallë dhe pasuron në vazhdimësi me libra, dokumente, fotografi, ku nuk mungon as ditari i tij prej 40 vitesh. Libri ka qenë pasioni më i madh i tij, të cilin në këtë dekadë ai iu kthye jo vetëm si lexues, kumtues e artikullshkruar, por si një autor i mirëfillt në rrafshin e librave të natyrës studimore.

Mark Mesuli rron në vendlindjen e tij në Gjegjan, duke nxjerrë nga duart punë të vyera monografike, por ai është përherë në lëvizje, në kontakte me studiuës, biblioteka e arkiva, në kërkim të vlerave, në Tiranë, lezhë, Shkodër etj. Ai është një shembull se si mund të punohet mbi letra kudo, nëse nuk të mungon zelli dhe përkushtimi, ku herë-herë pena mund të këmbetet me gërsherën e krasitjes së hardhive. Përndryshe, mund të rrosh mes metropolit dhe të mos shkruash gjera të vlefshme. Ndërkohë që ka një marrosje të jo pak shkruarëve (asesi autorë) pas publikimeve për njerëzit e fisit e të familjes, paçka mospasjes së meritimeve të nevojshme për të qenë njerëz publikë. "Fisi" i Mark Mesulit përkundrazi janë korriçetë meteorikë të trevës së tij me renomë kombëtare, veçanërisht ata të luginës së Fanit të Madh, që përndryshe mund të thirrje Mirdita e Epërme. Gjithsesi, ky libër është një odeon për një artist të papërsëritshëm të skenës popullore shqiptare, ku ndërthuret mjeshtrërisht rrëfimi i protagonistit me një lëndë të tërë dëshmuese nga ana e të tjerëve.

BALET

JEPET sërish në datat 22, 24, 26 Shtator 2014. MK në bashkëpunim me TKOB kanë menduar t'i japin një mundësi tjetër ngjitjeje në skenë këtij baleti për të gjithë ata që nuk patën mundësi ta shohin

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Mirëpritur ngjitja në skenë e Baletit me koreografi të Ilir Kernit, "Balloja e Diplomës", e cila mbrëmë e kishte natën e dytë të ngjitjes në skenë pas shfaqjes që u dha të premten. Shfaqja u prit me interes nga publiku dhe nuk munguan duartrokitjet, sidomos të shtunën në mbrëmje ku publiku ishte më i madh në numër. Kjo shfaqje do të jepet sërish në datat 22, 24, 26 Shtator 2014. Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, kanë menduar t'i japin një mundësi tjetër ngjitjeje në skenë kësaj vepre "për të gjithë ata që nuk patën mundësi ta shohin". Muzika e Johann Strauss, vjen në koreografinë e Ilir Kernit (sipas David Lichine), me skenografinë e Tonin Prendit, kostumet e Elva Bellës, me ndihmën e baletmaestrit Alisa Gjoni e me interpretimin e solistëve dhe trupës së baletit të TKOB-it, të cilët nëpërmjet kostumeve të bukura, muzikës së gjallë dhe interpretimit të tyre, sollën një mbrëmje mjaft të gëzueshme. Disa nga pjesët muzikore më të bukura nga Johann Strauss, janë përzgjedhur për të krijuar sfondin e kësaj "Mbrëmjeje Diplome", e cila zhvillohet në konviktin e vazave ku të ftuar janë edhe djemtë e një garnizoni aty afër. "Balloja e Diplomës" u shfaq si një premierë në datat 14, 15 dhe 16 mars 2014, dhe ajo ngjiti në skenë jo vetëm Ilir Kernin, por edhe balerinët maturantë, të cilët e interpretuan shfaqjen edhe në data 23 dhe 24 maj, si pjesë e projektit "Edukimi përmes artit". Ky projekt është zhvilluar nga Ministria e Kulturës, me qëllim promovimin e muzikës

Rikthehet në Teatrin e Operës "Balloja e Diplomës"

Drejtori Ilir Kerni: Në TKOB do të jepen 52 shfaqje të kalendarit artistik për muajt shtator-dhjetor 2014



NË FOTO: Baleti "Balloja e Diplomës" dhe (lart) Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit

klasike, baletit klasik dhe modern, edukimin e shijeve të shëndetshme artistike e muzikore, afrimin e publikut të ri përmes shfaqjeve tërheqëse për moshat e tyre dhe nivelin e njohurive muzikore që

ata kanë marrë, si dhe njohjen e artistëve me të shquar të skenës kryesore artistike të vendit, por edhe të veprave të kompozitorëve të mëdhenj botërorë si Verdi, Wagner, Puçini, Mozart, etj.

JA ÇFARË PRITET NGA SEZONI I RI ARTISTIK

Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit ka publikuar kalendarin artistik të shfaqjeve të sezonit të ri artistik për muajt shtator-dhjetor

2014. Rreth 52 shfaqje artistike, nga të cilat 11 vijnë si pjesë e projektit "Edukimi përmes artit", do të nxisin vëmendjen e publikut kryeqytetas për t'u afruar drejt artit klasik shqiptar, atij botëror, si dhe folklorit tonë. Sipas drejtuesve të TKOB-it nuk do të mungojnë këtë sezon të ri artistik dhe mjaft surpriza, ku do të ketë shfaqje të trupës së TKOB-së brenda dhe jashtë vendit. Mjaft shfaqje artistike, produksione të rëndësishme, opera dhe balette të cilat janë të njohura dhe që kërkohen vazhdimisht nga publiku, premiera baletesh, koncertesh simfonike, mbrëmje Gala me të ftuar të veçantë, si dhe rikthimi i personazheve të njohur të cilët janë pritur mjaft mirë nga publiku, janë pjesë e këtij 4 muajori të ri artistik, i cili pritet të jetë mjaft i suksesshëm. Pas nisjes së sezonit të ri artistik në datat 7 dhe 9 shtator, me projektin "Koreolabos" projekt ky i cili ka si qëllim që të afrojë koreografitë e rinj, dhe t'u japë atyre mundësinë për të sjellë krijimet e tyre koreografike në skenë, ka qenë radha e "Simfonia Nr 1, Titanët" e Mahler-it e cila u shfaq për publikun në 10 dhe 11 shtator, për tu pasuar nga "Balloja e Diplomës" shfaqja e cila rivjen në skenë e TKOB-së në 12 dhe 13 shtator. Në kuadrin e vizitës së Papa Françeskut në Tiranë, TKOB në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës do të zhvillojë një tur në qytetet si Durrësi, Tirana dhe Shkodra, me pjesëmarrjen e Korit, Solistave dhe Orkestrës së TKOB. Edhe në hollin e tij, do të vijojnë koncertet, ku artistët e TKOB-së do të sjellin falas për publikun disa nga pjesët më të bukura të kompozitorëve të njohur, si dhe arie nga opera të shumëpëlqyera nga publiku. Disa nga veprat e sezonit janë: "VVaiting for the Pepe", Durrës, Tiranë, Shkodër, "Ballo e Diplomës", opera "Traviata", festivali "Diferent Trains", "La stravaganza", projektin "Koreolabos", opera "Tosca", etj

Zvicër

Çelet ekspozita "Besa", si u mbrojtën hebrenjtë nga shqiptarët gjatë Luftës II Botërore

Në Biel-Bienne, Zvicër është hapur raundi i dytë i ekspozitës "Besa", projekt i cili po realizohet nën kujdesin e tri ambasadeve, të Shqipërisë, Izraelit dhe Kosovës në Zvicër. Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm një numër i madh personalitetesh nga politika, duke filluar nga ambasadori i Izraelit në Zvicër Yigal Caspi dhe ai i Kosovës, Naim Malaj, Konsullja e Shqipërisë Eliverta Radomi dhe sekretari i parë i Ambasadës, Kastriot Noli. Ndërkaq hapjen e aktivitetit e kanë bërë anëtarë i komitetit për organizim në nivel të Zvicrës, Alain Pichard bashkë me këshilltarin në Asamblenë e qytetit Biel/Bienne. Një program i pasur me muzikë, me fjalime përshëndetëse nga shumë oratorë ka shoqëruar aktivitetin kryesor, ekspozitën tashmë të njohur



që ka bërë xhiro nëpër botë, me fotografi të fotografit amerikan Gerschmann. Grupi shqiptar i të rinjve valltarë me emrin "Besa", si dhe grupi i instrumentistëve zviceranë interpretuan për të pranishmit valle shqiptare dhe pjesë muzikore zvicerane dhe izrealite. Ndërsa e veçantë e kësaj mbrëmjeje kanë qenë prezantimi i një familjari të shqiptarëve që kanë mbrojtur hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rexhep Hoxha kishte ardhur posaçërisht nga Tirana për të sjellë porosinë e përcjellë nga babai i tij, i cili për 14 muajt kishte strehuar dhe mbrojtur në shtëpinë e tij një familje hebreje. Për rastin e tij bën fjalë

edhe filmi amerikan "Besa" që do të prezantohet sot, të dielën, në një nga kinematë e qytetit Biel. Ekspozita do të mbahet e hapur deri me datë 19 shtator

Durrës

Miki Manojloviç: Shqipëria nuk është për mua tokë armike

Aktorit serb Predrag (Miki) Manojloviç, juria e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Durrësit, pas ftesës nga organizatorët e festivalit i ka akorduar çmimin e Argjendtë të Durrësit. Manojloviç është aktori më i vlerësuar në Jugosllavinë titiste e post-titiste, sidomos në filmat e regjisorit Emir Kosturica. Ai njihet edhe si drejtor i Qendrës Serbe të Filmit që nga viti 2009. Këtë të premte ai ishte i pranishëm në një konferencë shtypi në teatrin "Aleksandër Moisiu", në kuadrin e Durrës Internacionale Film Summerfest. Miki shumë i përmbytur iu përgjigj pyetjeve të pjesëmarrësve shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova, si edhe të huajve, që ndjekin festivalin. Këto pyetje



kishin të bënin me karrierën e shkurtër të Mikit, me planet për të ardhmen e afërt, me bashkëpunimet evropiane të viteve të fundit, etj. Gazetarët duke pasur parasysh deklaratat antishqiptare dhe anti-NATO të Mikit në vitin 1999, e pyetën z.Manojloviç sesi e ndjente veten në këtë vizitë të parë "në tokën armike të Shqipërisë". Me shumë diplomaci z. Manojloviç u përgjigj, që ai nuk është politikan, por artist. Ai theksoi se "nuk e konsideroj Shqipërinë si tokë armike".



NGA ARBEN DUKA

SATIRË POLITIKE

I egër si një shpellar!

vijon nga faqja 1

...Duket se tani,
sa ka dalë nga shpella,
dhe s'është hiç çudi,
të shkaktojë të vjella!

Të isha si Rama,
vetëm fare pak,
Salën do ta bëja,
që të viltte gjak!

E bëja të mbetej,
nëpër historira,
se Sala për Ramën,
sajon poshtërsira!..

Se Sala për Ramën,
sajon poshtërsira,
për njerzit e tij,
thotë gjëra të ndyra!

Rama s'është i humbur,
ta marr unë në mbrojtje,
por ndihem shumë keq,
kur flet ai mortje!..

S'është punë opozite,
ç'thotë plaku Sali,
po është provokim,
edhe poshtërsi!

Siç provokoi Ramën,
dje Sali Qymyri,
ndaj dhe ta kërcasin,
edhe Strazimiri!

Njerzit nëpër deje,
nuk kanë ujë-po gjak,
ndaj dhe ta kërcasin,
me ndonjë shuplakë!

Ndaj dhe ta kërcasin,
me ndonjë shuplakë,
midis nesh ta flasim,
kjo është fare pak!

Ku e gjejnë guximin,
këta qelbësira,
që thonë për njerzit,
fjalët më të ndyra?!

Se dhe deputeti,
që në sallë rri,
përpara çdo gjëje,
është një njeri!

Nëse një njeri,
e shan në publik,
një kundërpërgjigje,
do ta kesh-or mik!

Ky refleks ka qënë,
dhe do jetë përhera,
ku nuk bën punë fjala,
ka stile të tjera!..

Po ç'logjikë që ka,
kjo racë legeni:
"Neve do t'ju shajmë,
po ju mos u ndjeni!!"

Kush i shan kolegët,
me bajga në gojë,
për një dru të mirë,
gjithnjë ka nevojë!..

Them në asnjë rast,
dhunën s'e sajdis,
por s'mund të dëgjoj,
se si shan një pis!..

Se si shan një pis,
një nga më të vjetrit,
dhe cenon pa turp,
familjen e tjetrit!

Rama s'mund ta rrabi,
s'e lë pozicioni,
duhet-ju të tjerët,
fort të reagoni!..

Fort të reagoni,
mbi fjalët së thika,
që në politikë,
të kthehet etikë!

Të ndryshojë etika,
sa më parë këtu,
ndryshe në Kuvënd,
prapë do kemi dru!

→ Letra nga populli

Akuzat e Berishës kundër Ramës, të trasha, bajate, djallëzore dhe të dëshpëruara..

NGA VALTER VLORA

Në ceremoninë e radhës, në përkujtim të vrasjes së Azem Hajdarit, pikërisht tek vëndi ku ai u qëllua në rrethana të dyshimta dhe të diskutueshme, duhet të sundonte pagja dhe solemniteti, respekti dhe vlerësimi për Azemin. Por jo! Pikërisht aty, Berisha u shfaqua si shpesh here dhe foli me një urrejtje patologjike kundër Ramës në mbrojtje të Fullanit. Ai i shtangu të gjithë pjesëmarrësit, shtangu vetë Bashën, që e ndjeu se ç'marrëzira thosh Saliu, ndaj dhe u mundua të rikuperonte diçka nga ai histerizëm banal. Dhe çuditërisht, është hera e parë në historinë e tij politike që Berisha e ndjeu se kishte tejkaluar çdo masë të pranuar njerëzore, ndaj tha se këto ishin vetëm mendimet e tij dhe jo të PD-së. Asnjëherë nuk e ka artikuluar këtë frazë. Pse e tha aty, akoma nuk e dimë saktësisht arsyen. Ky ka qënë sulmi

më banal, më bajat, më i trashë dhe me më të pavërteta kundra Edi Ramës. Paturpësisht, Berisha u fut në histori familjare të "vitit zero", që ne nuk dimë të kenë ndodhur vërtet. Po dhe këtu ky sulm i turpshëm, nga një plak shtatëdhjetëvjeçar, nuk qëndron me çështjen se gruaja e Fullanit i ka dhënë certifikatën e ndershmerisë edhe Ilir Metës. Ndaj plaku i shejtanëzuar dhe i shkalluar u kujdes që të mos e përmëndte sloganin "Dyshja Rama-Meta". Të gjithë jemi dëshmitarë se Rama nuk lëvizti as gishtin kundër Fullanit dhe për këtë ka marrë kritika të shumta. Ai minimalisht nuk kërkoi as dorëheqjen e Fullanit, në respekt të ndarjes së pushteteve. Edhe për këtë mori kritika. Biles, Rama ka kryer mosveprime, që e "penalizojnë". Rama nuk ka pezulluar nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës Dhorë Kulen, i cili, në kundërshtim me Ligjin për Bankën, është me veshje politike dhe ka kryer veprimtari politike

në dobi të Partisë Demokratike. Të njëjtën gjë ka bërë dhe ish-këshilltari i Berishës, Petraq Milo dhe Rama as këtë s'e ka pezulluar.

Berisha është tërbuar në ekstrem, jo pse Rama ka vepruar, por pse s'ka vepruar dhe nuk e ka koklavitur situatën. Rama nuk ka asnjë akses në Prokurori, por ka qënë i bindur se Fullani do të përfundonte në burg, ndaj dhe Rama i ka lënë ujrat të rrjedhin, duke mos humbur afatet ligjore dhe duke mos u kompromentuar.

Rama edhe mund t'i kishte pezulluar dy delfinët e Berishës, por s'u nxitua, mbasi e dinte se mbas Fullanit do të binte i gjithë Këshilli Mbikqyrës, si përgjegjës kryesor edhe për mëkatet e Fullanit.

Rama ja la në dorë Drejtësisë gjithë procesin, duke evituar forcon dhe nxitimin, duke u treguar, për çudi, më i matur dhe më gjakftohtë se gjithë pjesa tjetër e politikës.

Pikërisht tani, kur Berisha ka kaluar

në tërbim proverbial, është hapur rruga për të gjitha ndryshimet dhe emërimet në Bankën e Shqipërisë, me guvernatorin, zv.guvernatorin që mungon dhe atë që është, antëarin e dorëhequr, dy, që u ka mbaruar mandati dhe dy, që nuk janë zgjedhur kurrë. Në këtë proces, Rama ka ftuar për bashkëpunim Bashën dhe i ka bërë thirrje për konsensus Nishanit. Berisha është tërbuar, mbasi nuk mund të influencojë më mbi procesin dhe emrat konkretë. Ai ka marrë mesazhin se Gjoni, guvernatori në detyrë dhe njeriu më i afërt i familjes Berisha, nuk do të jetë më aty, as si zv.guvernatore e jo më të bëhet guvernator. Nga këto është tërbuar Saliu, jo nga arrestimi i Fullanit, që ka qënë një gjë e sigurtë se do të ndodhte.

Berisha nuk po mendon vetëm për kunatë-këshilltare, por për gjithë rrjetin nepotik, që kish krijuar rreth Fullanit dhe që e kurorëzoi punën me vjedhjen legjendare të Thesarit të Shtetit

Shënim: Për mendimet dhe sugjerimet që keni për këtë faqe mund të kontaktoni me mesazhe me numrat e telefonit 0696031369 & 0696546873. Mendimet dhe sugjerimet tuaja do të vlerësohen nga autori

» REAGIMI

"NË FAKT nuk është e imja dhe nuk po e shes si e tillë. Thjeshtë ishte një backdrop i bukur për një foto"



STILISTJA

Lori bën shaka pa kripë, tregon një Lamborghini prej ari!

Trashëgimtarja e "Top Media", tur pushimesh edhe në vjeshtë

Ajo është vajza e cila shumë prej nesh duhet ta kenë zili, jo vetëm për pasurinë që ajo tashmë ka të trashëguar nga babai i saj, por për bukurinë që ajo karakterizon. Këtë herë duket se ka qenë në qendër të vëmendjes për shkak të një fotoje të publikuar në rrjetet sociale ku ajo ka qenë

përball një Lamborghini dhe shkruan "You know I got it"... Kaq ka mjaftuar dhe komentet kanë pushtuar faqen e profilit të saj në "Instagram" dhe "Facebook" ku shumë prej tyre kanë shprehur hapur zilin e të qenit i pasur në Shqipëri. Kjo ka bërë që Lori të reagojë sërish duketë: "Në fakt nuk është e imja dhe nuk po e shes si e tillë. Thjeshtë

ishte një backdrop i bukur për një foto". Siç dihet tashmë, Lori Hoxha, që është edhe trashëgimtarja e re e "Top Media" ka treguar luksin e saj të fundit. Nëse për dikë mund të jetë një ëndërr shumë e largët, edhe pse Lori ka bërë një shaka me kripë me fansat e saj, një Lamborghini e veshur mund të jetë një ëndërr që ajo mund ta bëjë realitet.

Modelja

Shkëndije Mujaj tregon "zogun"



Shkëndije Mujaj nuk ndalet së provokuari! Këtë herë ka provokuar në rrjetet e saj sociale me një foto ku ekspozon pa kursim. Këngëtarja ka treguar në foto trupin në gjysëm errësirë me kanatiere të shkurtër në ngjyrë por-

tokalli dhe të brendshme të kuqe. Fotoja ka shkaktuar shumë komente nga fansat pasi Shkëndija ka provokuar duke ulur të brendshmet pavarësisht gjysëm errësirës. Duket se Shkëndija nuk ka ndërmend të ndalojë deri sa t'i heqë të gjitha.



Kalendari Kulturor

TEATRI "METROPOLIT"

- Teatri i Metropolit e nis sezonin artistik me një premierë teatrale që mban emrin e autorit dhe regjisorit Armand Bora. I njohur dhe i vlerësuar në aktivitetin e tij në skena të ndryshme të teatrit këtë herë autori dhe regjisor Armand Bora sjell veprën teatrale "Ata hyjnë pa trokitur", e cila në skenën teatrale do të interpretohet nga dy emra të njohur të teatrit: Alfred Trebicka dhe Rozi Kostani, të cilët do të jenë edhe protagonistët e kësaj premiere që pritet të vijë në skenë në muajin tetor.

PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 11.09.2014- 17 .09.2014



SALLA 1

- "The November Man" 2D / 15:30 / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Escape From Planet Earth" 3D / 10:30 / Çmimi 500 Leke
- "The Hundred-Foot Journey" 2D / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- "Step Ul: All In" 3D / 13:00 / Çmimi 500 Leke
- "Sex Tape" 2D / 22:30 / Çmimi 500 Leke

SALLA 2

- "The November Man" 2D / 18:30 / Çmimi 500 Leke
- "Escape From Planet Earth" 3D / 13:30 / Çmimi 500 Leke
- "The Hundred-Foot Journey" 2D / 21:00 / Çmimi 500 Leke
- "Step Ul: All In" 3D / 11:00 / Çmimi 500 Leke
- "Sex Tape" 2D / 16:00 / Çmimi 500 Leke

KINEMA AGIMI

- "The November Man" 2D / 17:30 / 20:00 / Çmimi 500 Leke
- "Escape From Planet Earth" 3D / 10:30 / 12:30 / Çmimi 500 Leke
- "The Hundred-Foot Journey" 2D / 22:00 / Çmimi 500 Leke
- "Step Ul: All In" 3D / 15:00 / Çmimi 500 Leke
- PREMIERE BOTERORE DT. 18.09.2014
- 1- The Maze Runner 2D
- Teatri i Metropolit



Sot do të zhvillohet java e katërt e kategorisë Superiore Duro bën gati 'partizanët': Pas Skënderbeut, radhën e ka Kukësi

— Sot do të zhvillohet java e katërt e kategorisë superioare. Spikasin ndeshjet Flamurtari – Vllaznia që do të zhvillohet në Vlorë dhe Kukësi-Partizani. Pas fitores me Apoloninë, Flamurtari kërkon që të vazhdojë me momentin mirë dhe synon pikët e plota edhe me Vllazninë, e cila vjen pas barazimit dramatik me Tiranën brenda.

Ndërsa Partizani shkon me entuziazëm në Kukës, teksa pak ditë më parë mposhti kampionët e Skënderbeut. Në prag të ndeshjes, trajneri Duro shprehet optimist. "Të dielën na pret një tjetër përballje e vështirë pasi do të luajmë ndaj Kukësit një tjetër rival për titull. Na pret një ndeshje e vështirë

por dhe tepër e rëndësishme dhe do të ketë të njëjtin vlerësim si me Skënderbeun. Do të ballafaqohemi ndaj një skuadre e cila dy vitet e fundit është nënkampione e vendit dhe me lojtarë ndër më të mirët e kampionatit shqiptar. Mendoj se do të jetë një përballje shumë interesante dhe kërkoj nga futbollistët e mi të japin

maksimumin në fushë pasi e theksoj se kam ndërtuar një ekip që mund të përballlet me sukses ndaj çdo kundërshtari. Edhe në Kukës do të luajmë shanset tona për të regjistruar një rezultat pozitiv" tha ai. Në ndeshjet e tjera Teuta pret Laçin, Skënderbeu shkon në Fier, ndërsa Tirana pret Elbasanin.

Dhuna, FSHF "masakron" Tiranën dhe Vllazninë

Shkodranët dënohen me 10 ndeshje, bardheblutë me 15

DYLBER BALLA
TIRANË

Federata Shqiptare e Futbollit përmes Komisionit të Disiplinës i ka dhënë një përgjigje të fortë dhunës në stadiumin "Loro Boriçi" në ndeshjen mes Vllaznisë dhe Tiranës. Pas mbledhjes së provave Komisioni vendosi të dënonte Tiranën me 15 ndeshje pa tifozë, grupimin e tifozëve "Tirona Fanatics" për të gjithë edicionin dhe 500 mijë lekë gjobë. Ndërsa Vllaznia dënohet me 10 ndeshje pa tifozë, 1 milionë lekë gjobë. Në vendim thuhet se "Vllaznia për dështim në përmbushje të përgjegjë-

VENDIMI

Tirana dënohet me 15 ndeshje pa tifozë, "Tirona Fanatics" për të gjithë edicionin dhe 500 mijë lekë gjobë. Vllaznia dënohet me 10 ndeshje pa tifozë, 1 mln lekë gjobë.

sive për organizimin e një ndeshje futbolli, përgjegjësi për sjelljen e gabuar të spektatorëve me pasojë hedhjen e sendeve të forta në fushën e lojës duke shkaktuar akte të dhunës dhe ndërprerje të përkohshme të lojës dënohet me: Zhvillimin e 10 ndeshjeve pa spektatorë dhe 1.000.000 Lekë gjobë. Tiranën për përgjegjësi në sjelljen e gabuar të spektatorëve të saj, me pasojë hedhjen e sendeve të forta në fushën e lojës duke shkaktuar akte të dhunës dhe ndërprerje të përkohshme të lojës si dhe duke pasur akte të ngjashme të përsëritura dënohet me : Zhvillimin e 15 ndeshjeve pa spektatorë dhe 500.000 Lekë gjobë. Grupimi i tifozave "Tirana Fanatics" për sjellje të dhunshme të përsëritura në stadiume dënohen me mospjesëmarrje në të gjitha aktivitetet futbolistike për sezonin 2014-2015" thuhet në njoftim. Përsa i përket javës edhe Partizani është dënuar me 50 mijë Lekë gjobë për sjelljen e tifozëve. Vendimi nuk është mirëpritur nga asnjë nga ekipet duke bërë gati dokumentet për ta apeluar. Klubi Vllaznia ka njoftuar se ditën e hënë do të deponojë Apelinin e çështjes. E njëjta gjë edhe për ekipin e Tiranës, të cilët nuk janë pajtuar me vendimin, pasi më parë kërkuan fitoren në tavolinë, teksa fajësuan për goditjen e presidentit Halili, tifozët e Vllaznisë. Kujtojmë që nga përlshjet në stadiumin e Shkodrës mbetën të plagosur 4 policë, disa tifozë dhe u arrestuan 13 të tjerë, 6 nga Tirana dhe 7 nga Shkodra, ndërsa u shoqëruan 34 nga Tirana dhe 7 nga Shkodra. Hetimet vazhdojnë nga policia për arrestimin e disa personave të tjerë, mes tyre të autorit të dyshuar të goditjes së Refik Halilit.



Reagimet

Vllaznia

Klubi ka deklaruar se do të apelojë vendimin ditën e hënë, ndërsa tifozët kanë paralajmëruar protestë nëse të arrestuarit nga Vllaznia nuk do të lirohen deri sot.

Tirana

"Tirona Fanatics" ka reaguar pas vendimit të FSHF. "Edhe FSHF pjesë e skenarit të dhunës! Askush s'na ndalon dot të futemi në stadium" shkruan grupimi i tifozëve.

Kategoria e Parë

Shulku: Starti kur policia të garantojë rend e siguri

— Sekretari i FSHF, Ilir Shulku ka sqaruar shtyrjen e Kampionatit Kombëtar të Kategorisë së Parë dhe Kupës së Shqipërisë. Shkaqet e shtyrjes janë, mos marrja për sipër e policisë për zhvillimin e ndeshjeve, mosplotësimi i dokumentacionit, infrastruktura dhe mos shlyerjen e detyrimeve

sipas rregullorevë të FSHF. Pas mbledhjes së informacionit do të vendoset për masat dhe fillimin e kampionatit. Shulku përsëriti qëndrimin zyrtar të FSHF, se pa një veprim profesional dhe efikas të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë, FSHF e vetme e ka të vështirë të reagojë ndaj veprimeve

të tilla të dhunshme dhe mbarëvajtjes së ndeshjeve të Kategorisë së Parë dhe Kupës. Të hënë do të mbillet Komisioni Anti-Dhunë ku do të diskutohet në lidhje me ngjarjet e fundit dhe për masat që duhet të merren në mënyrë që të parandalohen veprime të tilla huligane në futbollin shqiptar.

Kalendari

Premier League

- Arsenal 2 - 2 Manchester City
- Chelsea 4 - 2 Swansea City
- Crystal Palace 0 - 0 Burnley
- Southampton 4 - 0 Newcastle
- Stoke City 0 - 1 Leicester City
- Sunderland 2 - 2 Tottenham
- West Bromwich 0 - 2 Everton
- Liverpool 0 - 1 Aston Villa

Bundesliga

- Bayern Munich 2 - 0 Stuttgart
- Borussia Dortmund 3 - 1 Freiburg
- Hertha Berlin 1 - 3 Mainz 05
- Hoffenheim 1 - 1 Wolfsburg
- Paderborn 0 - 0 Cologne
- Monchengladbach 4 - 1 Schalke 04

La Liga

- Barcelona 2 - 0 Athletic Bilbao
- Malaga 0 - 0 Levante
- Real Madrid 1-2 Atletico Madrid

Seria A

- Empoli 0 - 1 Roma
- Juventus 2-0 Udinese

Nesër

Premier League

- 17:00 Manchester United - QPR

Seria A

- 12:30 Sampdoria - Torino
- 15:00 Cagliari - Atalanta
- 15:00 Fiorentina - Genoa
- 15:00 Inter - Sassuolo
- 15:00 Lazio - Cesena
- 15:00 Napoli - Chievo
- 20:45 Parma - Milan

La Liga

- 12:00 Rayo Vallecano - Elche
- 17:00 Valencia - Espanyol
- 19:00 Sevilla - Getafe
- 21:00 Granada - Villarreal

Bundesliga

- 15:30 Frankfurt - Augsburg
- 17:30 Hannover - Hamburger

Ligue 1

- 14:00 Lille - Nantes
- 17:00 Guingamp - Bordeaux
- 21:00 Evian - Marseille

Super liga

- 20:00 Teuta - Laci
- 20:00 Apolonia - Shkenderbeu
- 17:00 Tirana - Elbasani
- 17:00 Flamurtari - Vllaznia
- 13:00 Kukësi - Partizani

LAJME
nga bota

Shkëputja e Skocisë, oferta e reziqe

— Me afrimin e votës së 18 Shtatorit lidhur me shkëputje apo jo nga Britania e Madhe, mbi skocezët shtohen si ofertat, ashtu edhe presionet. I angazhuar maksimalisht ta mbajë Skocinë brenda Mbretërisë së Bashkuar, kryeministri britanik David Cameron premtoi pushtet më të madh rajonal dhe përfitime të tjera. Por, sipas të përditshmes "Daily Mail", ka një kërcënim që rëndon mbi ta, nëse votojnë në kampin pro-shkëputjes. Një votë në favor të Pavarësisë, - thotë gazeta, - do t'i rrisë faturat e telefonit për miliona skocezë. Frika e ndarjes ka çuar në largimin e 17 miliardë paundëve nga Mbretëria e Bashkuar, muajin që shkoi.

Kerry: 40 vende tashmë kundër ISIS-it

— Sekretari amerikan i Shtetit John Kerry, pas Turqisë, do të shkojë në Egjipt për të kërkuar ndihmë në luftën ndaj ISIS-it. Gjatë vizitës të premtën në Turqi, sekretari i Shtetit John Kerry tha se rreth 40 vende kanë ofruar nivele të ndryshme mbështetjeje për një koalicion të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara kundër Shtetit Islamik. Që nga koha kur Shtetet e Bashkuara filluan sulmet ajrore ndaj militantëve në Irak muajin e kaluar, zyrtarët amerikanë po i quajnë veprimet ushtarake luftë, ndërkohë që po formohet një koalicion ndërkombëtar për të luftuar Shtetin Islamik. Ndërkohë, edhe Athina zyrtare i është bashkuar aleancës globale të shteteve kundër ISIS-it.

Kievi: Moska synon Bashkimin Sovjetik

— Në një sulm të drejt-përdrejtë verbal ndaj Moskës, kryeministri ukrainas e akuzoi se po përpiqet ta eliminojë vendin e tij e të rikthejë Bashkimin e dikurshëm Sovjetik. Pavarësisht përpjekjeve të diplomacisë, Ukraina - tha shefi i Ekzekutivit në Kiev, - vazhdon të jetë në gjendje lufte, ndërsa agresori kryesor është Rusia. Mëngjesin e djeshëm, zyrtarë të doganës ruse njoftuan se një autokolonë me ndihma ka kaluar nga Rusia në Ukrainën lindore.

Dhuroni Minuta SMS MB

Andi Zemërgjeri

Vodafone
Power to you



Transferoni
60

Minuta, SMS dhe MB
me miqtë tuaj në Vodafone.
Telefoni 131.

Cmimi 70 lekë me tvsh. Transferta është e vlefshme për 24 orë. Oferta e vlefshme deri më 30 Shtator 2014. Për më shumë telefoni 140 ose vizitoni vodfone.al

JWT
SPOT TIRANA

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm & Ekonomi ; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Brahim Shima ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ;
Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sport: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri ; Eëbsite: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini tel: +355696088847
Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Eëbsite: eëë.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë
Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com